



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr 2417 Prot

Tiranë, më 02.06. 2022

U D H Ë Z I M

Nr 354, datë 02.06.22

**“PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE PËR SHËRBIMIN E STREHIMIT
EMERGJENT TË SIGURTË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3 të nenit 27 dhe 51 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e standardeve për shërbimin e strehimit emergjent të sigurtë, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, apo dhe/ose personave juridik publik/privat, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



STANDARDET

PËR

SHËRBIMIN E STREHIMIT

EMERGJENT TË SIGURTË

Falënderime

Standardet e Shërbimit Emergjent të Sigurt për fëmijët në rrezik të menjëherëshëm u realizuan nga një grup pune të përbërë nga ekspertë kombëtarë, profesionistë, specialistë të Ministrisë së Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Standardet janë konsultuar me ekspertë dhe profesionistë të fushës si dhe me këshillat e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe jo publike, të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare si: përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Znj. Merita Xhafaj, Drrejtore i Përgjithshëm i Politikave dhe Programeve të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Xhilda Papajani, Përgjegjëse Sektori e Zhvillimit të Shërbimeve Sociale, përfaqësues të SHSSH, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, përfaqësues të Bashkive Tiranë, Durrës, Korçë dhe Dibër, Policisë së Shtetit, si dhe UNICEF, Save the Children, Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, Shoqata Kombëtare e Edukimit për Jetën (SHKEJ), Organizata Shoqërore për Përkrahjen e të Rinjve, Terre des hommes Albania dhe organizata të tjera joqeveritare.

Së fundmi, mirënjojja shkon veçanërisht përprofesionistët që punojnë në terren, për ofrimin e shërbimeve të emergjencës për mbrojtjen e fëmijëve, edhe në mungesë të burimeve të mjaftueshme. Përvoja dhe ekspertiza e tyre, por mbi të gjitha dëshira dhe vullneti për të vënë fëmijët në strehëz, pavarësisht vështirësive, kanë kontribuar në zhvillimin e këtij dokumenti.

Shkurtime

MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJA	Njësi Administrative
NJMF	Njesia për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVNR	Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës
SPSHSB	Struktura Përgjegjëse për Shërbimet Sociale në Bashki
SPSH	Strukturatë Policisë së Shtetit
SSEP	Shërbimi i Strehimit Emergjent të Sigurt
SHEMF	Shërbimet Emergjente të Mbrojtjes së Fëmijës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SHUSH	Shërbimet e Urgjencës Shëndetësore

Tabela e përmbajtjes

Shkurtim.....	3
Standardet për shërbimin e strehimit emergjent të sigurtë.....	7
Hyrje	7
Standardi 1: Qëllimi i shërbimeve	12
Shërbimi i strehimit emergjent të sigurtë zotëron një deklaratë ku shprehet misioni, shërbimet që do të ofrohen dhe një strukturë të përcaktuar qartë të shërbimeve që tregon kapacitetin për t'i vënë në zbatim shërbimet e deklaruara me stafin dhe infrastrukturën e nevojshme.....	12
Standard 2: Lloji i shërbimeve	13
SHSES ofron një paketë të plotë dhe eficiente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të fëmijëve, në bashkëpunim me ofruesit parësorë dhe alternativ të shërbimeve, për të mundësuar mbrojtjen e fëmijëve në nevojë për strehim emergjent të sigurtë.	13
Standardi 3: Pranimi i fëmijës, vlerësimi i nevojave dhe plani i ndërhyrjes për fëmijën.....	16
SHSES harton një plan të ndërhyrjes për fëmijën, në bashkëpunim me fëmijët/përfituesit e rritur të shërbimeve pasi fëmija është pranuar, (në përputhje me moshën dhe të kuptuarin e fëmijës) dhe aktorët e tjerë të përfshirë në masën e mbrojtjes. Në plan pëershruhen qartë nevojat e vlerësuara të fëmijës/përfituesit, burimet dhe veprimet që nevojiten për t'i zgjidhur ose përbushur këto nevoja.	16
Standardi 4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesve.....	18
SHSES nxit dhe praktikon tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin pa bërë diskriminim mbështetur në racën, ngjyrën, kombësinë, gjuhën, gjininë, orientimin seksual, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzënинë, të qenit fëmijë/prind, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitat gjenetike, aftësitë e kufizuara, përkatësinë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera.....	18
Standardi 5. Të dhënat personale të fëmijës/përfituesit dhe administrimi i tyre	20
SHSES mbledhin dhe ruajnë të dhënat personale të çdo fëmije/përfituesi, duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale, të vëmendshme dhe në funksion të mbrojtjes së tyre. SHSES krijon kushtet në mënyrë që administrimi i të dhënavë të bëhet në përputhje me normat ligjore dhe të mbështetet në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit.	20
Standardi 6.Menaxhimi dhe administrimi i brendshëm i SHSES	23
SHSES siguron mekanizmat e duhur formal të administritimit të brendshëm për funksionimin e qendrës dhe ekzekutimin e shërbimeve që ofron	23
Standardi 7. Siguria e përfituesve të shërbimeve dhe e stafit	25
Ofruesi i shërbimeve të marrë masat për sigurinë e stafit dhe të fëmijëve/përfituesve. SHSES të mbahet i paprekur dhe të ruhet fshehtësia e vendndodhjes së tij në çdo kohë. Çdo ofrues shërbimi të përcaktojë qartë mënyrat e trajtimit të situatave emergjente dhe të rreziqeve.	25

Standardi 8. Vlerësimi i shërbimeve të ofruara nëpërmjet inspektimit dhe monitorimit	26
Ofruesi i shërbimeve monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike cilësinë e shërbimeve të ofruara, për të rritur cilësinë e shërbimit të ofruar.....	26
Standardi 9. Buxhetimi i sigurtë i shërbimeve të ofruara në shërbimin e emergjencës.....	27
Ofruesi i shërbimeve duhet të sigurojë shërbime cilësore, bazuar në buxhet të garantuar për çdo shërbim dhe staf të përfshirë.....	27
UDHËZIM.....	Error! Bookmark not defined.
1. Deklarata e qëllimit	28
2. Llojet e shërbimeve	29
2.1 Kriteret e shërbimeve.....	29
2.2 Shërbime ditore.....	29
2.3 Mjedisi fizik.....	30
2.4 Shërbime shëndetsore	31
2.5 Ushqyerja, veshja dhe higjena.....	32
2.7 Shërbimi i transportit	34
3. Pranimi i fëmijës, vlerësimi i nevojave dhe plani i ndërhyrjes përfituesit.....	34
4. Të drejtat dhe përgjegjësitet e përfitueses	40
5. Të dhënat personale të fëmijës/përfituesit dhe mënyrat e menaxhimit të tyre	41
6. Menaxhimi dhe administrimi i brendshëm i SHSES	43
7. Siguria e përfituesve të shërbimeve dhe e stafit.....	45
8. Vlerësimi i shërbimeve të ofruara nëpërmjet inspektimit dhe monitorimit	47
9. Buxhetimi i sigurtë i shërbimeve të ofruara në shërbimin e emergjencës	48
Aneks 1: Deklarata e qëllimit	49
Aneks 2: Formular i hyrjes së fëmijës së pasqoqëruar në SHSES.....	60
Aneks 3: Formular i hyrjes së familjes/përfituesve në SHSES	62
Aneks 4: Vlerësimi i nevojave.....	63
Aneks 5: Faktorët e identifikuar të rrezikut	68
Aneks 6: Plani i ndërhyrjes	73
Aneks 7: Fleta e ditarit	74
Aneks 8: Formulari i miratimit për ndarjen e informacionit	75
Aneks 9: Përbledhje e rregullores së SHSES.....	76
Aneks 10: Përbledhje e të drejtave të fëmijëve/përfituesve	78

Aneks 11: Përbledhje e procedurave të ankimimit.....	79
Aneks 12: Formular për vlerësimin e ankimimit	81
Aneks 13: Formular i raportimit për fëmijën në nevojë për mbrojtje	82
Aneks 14: Formulari i largimit të përfituesve nga SHSES	84
Aneks 15: Formulari i largimit të fëmijës nga SHSES.....	86
Aneks 16: Proces verbal i shoqërimit të të miturit.....	88
Aneks 17: Proces verbal i shoqërimit të familjes	89

Standardet për shërbimin e strehimit emergjent të sigurtë

Hyrje

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të vlerësimeve të vazhdueshme përmbrrojtjen e fëmijëve, të cilët gjenden në rrezik dhe në nevojë përmbrrojtje, si edhe të ekzistencës së strehëzave të strehimit të përkohshëm emergjent të sigurtë, publike dhe jopublike, mori nismën për hartimin e standardeve të strehimit emergjent të sigurtë përfëmijët në rrezik të menjëhershëm që strehohen në streha të përkohshme të strehimit të sigurtë, me mbështetjen e World Vision në Shqipëri.

Fëmijë në "Rrezik i menjëhershëm"¹, konsiderohet situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, në momentin e identifikimit nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe, nëse lihet në rrëthanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, mund të abuzohet seksualisht, të trafikohet apo të jetë prehë e keqtrajtimeve të tjera, të konsideruara vepër penale, sipas Kodit Penal. Ndërhyrja, në këtë rast, duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut.

Ky dokument mbështetet në standardet e përgjithshme të shërbimeve shoqërore të miratuarame Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve shoqërore", VKM Nr. 659, date 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, përfëmijët në institucionet rezidenciale", VKM nr. 564, datë 12.8.2005 "Për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore", Ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM në funksion të tij, Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" dhe VKM-të në funksion të tij, Ligji nr.9669 dt.18.12.2006 "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar me Ligjin nr. 47/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, Udhëzim nr.582, datë 18.12.2017 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, në strehëzat shtëpi familje, përfëmijët 16–18 vjeç", VKM nr.505 datë 13.7.2011 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror përviktimat e dhunës në familje, në strehëzat rezidenciale, publike dhe jopublike". Këto standarde u hartuan në bashkëpunim me një numër të madh

¹Sipas VKM nr.578, dt.03.10.2018 "Procedurat E Referimit e të Menaxhimit të Rastit; Hartimi Dhe Përbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes; Financimi i Shpenzimeve përmbrrojtje Zbatimin etij, si dhe Zbatimi i Masave të Mbrojtjes"

- a) Në situatë të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo forme tjetër dhune dhe përfëmijës i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e Policisë së Shtetit apo të prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku qëndron fëmija nuk është i sigurt përfëmijë;
- b) Braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;
- c) Pa përkujdesje prindëror, pasi prindërit e tij janë arrestuar, shtruar në spital ose ndodhen në situata të tillë, për shkak të të cilave ata nuk mund të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore.

organizatash dhe profesionistësh nëfushën e shërbimeve sociale dhe specifikisht në punën me fëmijët e identifikuar në rrezik të menjëhershëm.

Ligji 121/2016 “Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës”, bazohen në parimet:

- 1- Universaliteti, fëmija është bartës i të drejtave që janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive;
- 2- Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën;
- 3- Drejtësia sociale;
- 4- Subsidiariteti;
- 5- Mbështetja shoqërore dhe ofrim i shërbimit të specializuar për çdo fëmijë;
- 6- Deinstitucionalizimi dhe decentralizim të shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijëve;
- 7- Partneriteti ndërmjet institucioneve dhe ndërhyrje ndërsektoriale;
- 8- Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës si dhe i të drejtave të njeriut;
- 9- Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar;
- 10- Mosdiskriminimi dhe barazia;
- 11- Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale;
- 12- Garantim i stabilitetit të vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimit të fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor e gjuhësor.

Gjatë hartimit të këtyre standardeve janë marrë në konsideratë të drejtat e sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa për të drejtat e Fëmijëve. Ligji nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përkufizon shërbimet rezidenciale si shërbime të kujdesit njëzetëekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në strehëzat rezidenciale, publike dhe jopublike. Po ashtu ky ligj në nenin 18 përcakton shërbimin e strehimit të përkohshëm për individët në rrethana emergjente si dhe nenin 19, i cili përcakton trajtimin e fëmijës në situatat e emergencës nëpërmjet shërbimeve të strehës së përkohshme. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, nen 56 (Kreu IV) përcakton dhënen e masës emergjente të mbrojtjes për rastet e fëmijëve në rrezik të menjëhershëm dhe mbrojtjen e tij nëpërmjet vendosjes në një strehim të sigurtë, siç mund të jetë (pika c e nenit 57) vendosja e fëmijës në një strehëzat rezidenciale kur nuk janë të mundura alternativat e tjera si familja biologjike apo kujdestare.

Përse janë të rëndësishme këto standarde?

Së pari, standaret synojnë përmirësimin e shërbimit dhe trajtimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të vendosur në strehim të përkohshëm emergjent dhe garantimin e të drejtave të tyre në ambientet e strehëzave të së strehimit emergjent të sigurt.

Së dyti, ato pasqyrojnë praktikat më të mira në këtë fushë dhe parimet ndërkombëtare të barazisë, respektimit dhe garantimit të vlerave dhe personalitetit të fëmijëve, të së drejtës për

të përfituar dhe për t'u mbrojtur, të mbrojtjes së informacionit për jetën vetjake, të dinjitetit dhe sigurisë, të integrimit social.

Së treti, vendosja e standardeve për strehimin e përkohshëm emergjent është e rëndësishme për të matur dhe për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shoqërore në përgjithësi por edhe të shumëllojshmërisë së shërbimeve për fëmijët në risk, duke u bazuar në parimet e subsidiaritetit që të ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

Së katërti, institucionet shtetërore duhet të vendosin rregulla dhe standarde të domosdoshme për cilësinë e shërbimeve ndaj fëmijëve, veçanërisht në kushtet e zhvillimit edhe të sektorit privat në fushën e shërbimeve shoqërore. Zbatimi i standardeve për shërbimin emergjencës së strehimit të sigurt është detyrim për të gjithë ofruesit të këtij shërbimi, publik, jopublik, nga OJF dhe nga ofrues privatë, dhe përbën kushtin e parë në procesin e licencimit, inspektimit dhe të vlerësimit të shërbimeve shoqërore.

Së pesti, legjislacioni i përmirësuar dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve shoqërore, i vendos strukturat vendore sidomos bashkitë përpara një përgjegjësie më të madhe, veçanërisht në proceset decentralizuese të shërbimeve ekzistuese dhe nevojës për të shtuar shërbime të reja. Vendosja e standardeve do t'i ndihmojë ato në përbushjen e funksioneve të reja në lidhje me plotësimin e nevojave për mbrojtje të fëmijëve në komunitetin, ku ata ushtrojnë autoritetin e tyre. Këto funksione lidhen me planifikimin me buxhet dhe jo vetëm në planet sociale, sigurimin e shërbimeve shoqërore në funksion të fëmijëve dhe familjeve të tyre dhe zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit lokal apo rajonal.

Ky dokument përbëhet nga nëntë standarde bazë. Krahas standardeve, jepen edhe kriteret e vlerësimit, treguesit e matjes së cilësisë së shërbimeve, udhëzues dhe rezultatet e pritura si dhe anekset përkatëse të cilat paraqesin format për secilën nga hapat e ndjekur për arritjen e qëllimeve të standardeve. Standartet janë hartuar si: standarde të shërbimit bazë dhe standarde të detyrueshme për të gjithë personat që ofrojnë shërbime publike dhe jopublike. Standartet mbulojnë disa fusha si:

- Qëllimi i shërbimit dhe përshtatshmëria sipas qëllimit;
- Llojet e shërbimeve;
- Vlerësimi i nevojave, plani i ndërhyrjes për fëmijën dhe largimi nga shërbimi;
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve;
- Të dhënat personale të fëmijëve dhe administrimi i tyre;
- Menaxhimi dhe administrimi Shërbimit së Strehimit Emergjent të Sigurtë;
- Siguria e përfituesve të shërbimeve (politikat e mbrojtjes së fëmijëve/përfituesve dhe e stafit (Kodi i etikës);
- Vlerësimi i shërbimeve të ofruara nëpërmjet inspektimit dhe monitorimit;
- Buxhetim i shërbimeve.

Në vijim të standardeve të shoqëruara me udhëzimet përkatëse për secilin standard, në këtë dokument është përfshirë edhe protokolli që parashikon zbatimin e standardeve për

shërbimin e strehimit emergjent të sigurt. Ky protokoll është zhvilluar duke u bazuar në konsultimet e kryera në muajt maj, qershor, korrik 2018 me PMF-të, ofruesit e shërbimeve mbrojtëse përfshirë fëmijët (statuorë-OJF-të), punonjës të institucioneve rezidenciale përfshirë fëmijët, punonjës të policisë së shtetit, prokurorë dhe gjykatës në 4 bashki të vendit (Tiranë, Korçë, Durrës dhe Dibër). Gjithashtu janë kryer konsultime edhe me strukturat qendrore që kanë përgjegjësinë të hartojnë dhe monitorojnë politika, strategji e legjislacion përfshirë siguruar mbrojtjen e fëmijëve. Protokolli siguron kuadrin përfshirë gjitha veprimet ndërmjet institucioneve dhe SHSES. Institucionet përfshijnë SPSHSB, NJMF-të, NJA, SPSH, SHSSH, Prokurorinë, Gjykatën, SSEP, SHUSH, OJF e tjetra bazuar në kontekstin e secilës bashki apo qark.

Standardet janë një parakusht përfshirë ofrimin e shërbimit, procesin e licencimit, kontrollit dhe vlerësimit të shërbimeve sociale, të cilat ofrohen nga subjekte publike dhe jopublike. Vënia në zbatim e paketës së standardeve të shërbimeve përfshirë këtë kategori garanton ofrimin e një shërbimi cilësor përfshirë fëmijët në rrezik të menjëherëshëm të vendosur pranë strehëzave që ofrojnë strehim emergjent të sigurt.

Kategoritë e përfituesve të shërbimit të strehimit emergjent të sigurt:

1. Të drejtën përfshirë përdorur shërbimin te strehimit emergjent të sigurt e kanë fëmijë (0-18 vjeç) individë ose familje me fëmijë që janë të dhunuar dhe nuk janë në gjendje që të sigurojnë mbrojtje, që janë në pamundësi përfshirë plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, përfshirë shkak të kushteve personale dhe sociale;
2. Shërbimi i strehimit emergjent të sigurt përdoret përfshirë fëmijën me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
3. Shërbimi i strehimit emergjent të sigurt përdoret përfshirë fëmijën me shtetësi shqiptare, i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
4. Shërbimi i strehimit emergjent të sigurt përdoret edhe nga shtetasit e huaj me fëmijë, personat pa shtetësi dhe refugjatët me fëmijë, por me banim në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e marrjes në mbrojtje.²

Përfituesit e shërbimit të strehimit emergjent të sigurt përfshijnë:

- a) çdo fëmijë në nevojë përfshirë mbrojtje të shoqëruar dhe të pashoqëruar, të abuzuar, viktima të dhunës në familje, viktima të trafikimit, viktima të mundshme të trafikimit;
- b) fëmijë me nevoja të veçanta (me aftësi të lehta të kufizuara);
- c) të rriturit³, në rastet kur janë prindër të shoqëruar me fëmijët e tyre, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
- ç) vajzat shtatzëna apo nënët fëmijë me fëmijë;

² Kushtet e marrjes në mbrojtje përfshirë: vendim gjykate, UMM, UPMM, UM, Masë emergjente e mbrojtjes, vendim i GTN në nivel bashkie.

³ Të rriturit në vijim të dokumentit do ti referohemi si pëfitues.

d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit, ose që kanë dalë nga institucionet rezidenciale të përkujdesit dhe kanë nevojë për shërbime përkohshme të strehimit të sigurt, në kushtet e marrjes në mbrojtje;

Kategoritë që nuk përfitojnë shërbimit të strehimit emergjent të sigurtë

1. Nuk përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror kategoritë e mëposhtme:

- a) shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit;
- b) azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit;
- c) shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave;
- ç) personat që vuajnë dënim me heqje lirie, me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Standardet pér shërbimin e strehimit emergjent të sigurt

Standardi 1: Qëllimi i shërbimeve

Shërbimi i strehimit emergjent të sigurt zotëron një deklaratë ku shprehet misioni, shërbimet që do të ofrohen dhe një strukturë të përcaktuar qartë të shërbimeve që tregon kapacitetin pér t'i vënë në zbatim shërbimet e deklaruara me stafin dhe infrastrukturën e nevojshme.

Rezultati i dëshiruar: Shërbimi i Strehimit Emergjent të Sigurt (SHSES) informon dhe udhëzon fëmijët në rrezik të menjëhershëm se çfarë mund të presin nga shërbimi, se si do të bëhet përkujdesja ndaj tyre dhe personin përgjegjës pér përkujdesjen. Një deklaratë e qartë mbi atë se si operon ky shërbim, është e disponueshme pér fëmijët, prindërit dhe të interesuarit e tjerë.

Kriteret e përbushjes së standardit	Treguesi i cilësisë	Udhëzimet
SHSES zotëron një deklaratë të qartë të misionit dhe qëllimit të shërbimeve, ku parashtohen shërbimet qe ajo ofron, është lehtësish i dukshëm pér të gjithë fëmijët, prindërit dhe të interesuarit e tjerë.	<ul style="list-style-type: none"> - Ka një dokument zyrtar që lidhet me deklaratën e qëllimit⁴ - Personeli zbaton politikën përkatëse të përshkruar në deklaratën e qëllimit. 	Duke qenë se fëmijët janë të vendosur në strehim emergjent kanë nevojë pér informacion të detajuar mbi shërbimet që do të marin dhe procedurat që do të ndiqen pér mbrojtjen e tij.
Fëmijët, përdoruesit e shërbimeve kane akses tek deklarata e qëllimit, misioni dhe rregullorja e SHSES ⁵ dhe kuptojnë në mënyrë të qartë shërbimet.	<ul style="list-style-type: none"> - Kopje të deklaratës se qëllimit janë të dukshme në të gjithë ambientet e SHSES dhe janë të disponueshme pér përdoruesit si dhe në forma lehtësish të kuptueshme edhe nga fëmijët. 	Duke qenë se ky shërbim frekuentohet nga grup mosha 0-18,dhe jo vetëm, deklarata e qëllimit dhe përshkrimi i shërbimeve duhet të përshtatet me të kuptuarin e kategorive brenda kësaj grupmoshe, si edhe pér fëmijët me aftësi të kufizuar.
Stafi ofron informacion lidhur me funksionimin e SHSES ose të shërbimeve që do t'i ofrohen fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> - Ka një rregullore të brendshme ku përcaktohen qartë deklarata e qëllimit dhe mënyrat e marrjes së njohurive rrëth përbajtjes së saj. -Stafi ka marrë në dijeni pér Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve nga Abuzimi (Child Safeguarding Policy) dhe e ka firmosur (përfshin stafin e kontraktuar, apo shërbim ofrues të tjerë që do të kenë kontakt me fëmijët). 	Dokumente të cilat shërbejnë pér të informuar përfituesin mund të janë: fletëpalosje, broshura etj. Përbajtja e tyre duhet të përfshijë: cili është ofrues që ofron shërbimet; misioni i tij, qëllimi i shërbimeve, llojet e shërbimeve që janë të disponueshme pér

⁴ Deklarata e qëllimit (protokoll i veprimeve per ofrimin e SHSES) gjendet e përshkruar në Aneks 1

⁵ Një përbledhje e rregullores së SHSES gjendet në aneks 9

		fëmijët, përshkrimin e procedurave si konfidencialiteti, siguria dhe mbrojtja e fëmijëve, etj.
Deklarata e qëllimit rishikohet e përmirësohet në mënyrë periodike dhe pas kësaj vijojnë modifikimet përkatëse ne dokumentet dhe praktikat e tjera	- Dokumentet dhe aktet zyrtare tregojnë që deklarata e qëllimit është diskutuar dhe rishikuar rregullisht.	

Standard 2: Lloji i shërbimeve

SHSES ofron një paketë të plotë dhe eficiente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të fëmijëve, në bashkëpunim me ofruesit parësorë dhe alternativ të shërbimeve, për të mundësuar mbrojtjen e fëmijëve në nevojë për strehim emergjent të sigurt.

Rezultati i dëshiruar: Shërbimet e ofruara nga SHSES plotësojnë nevojat individuale të çdo fëmije si person i marrë në mbrojtje për shkak të gjendjes në rrezik të menjëhershëm.

Kriteret e përbushjes së standardit	Treguesi i cilësisë	Udhëzimet
Fëmijët vendosen në një ambient të sigurtë, të qetë, sipas specifikave të grupmoshës, gjinisë dhe problematikave të fëmijës (fëmija në rrezik të menjëhershëm).	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumente në formë shkresore që të vërtetojnë pronësinë/ kontratë qeraje dhe qëndrueshmëria mbi objektin ku zhvillohet aktiviteti - SHSES të ketë hapësira që sigurojnë mirëqenien e fëmijës në përputhje me nevojat etj. - Ambientet të kenë dritë, me hapësira të përshtatura me grupmoshën e fëmijës, të pajisura me mobiljet e nevojshme. - Dritaret, prizat janë të sigurta përfshi fëmijët. Kanë kuti të ndihmës së shpejtë, mjetet e nevojshme përfshi fikjen e zjarrit, etj. - Numri i fëmijëve në dhomë jo më shumë se dy fëmijë. 	<p>Të jenë udhëzime të qarta sqaruese mbi mënyrën e ofrimit të çdo shërbimi, duke filluar nga cilësia e ushqimit, dieta ditore përfshi fëmijë, hapësira e akomodimit, kushtet e përshtatshme përfshi siguruar higjienë të pastër, etj.</p> <p>SHSES nuk duhet të ofrojë, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin objekt, dy lloje kujdesi që bien ndesh me interesin më të lartë të fëmijës, përdorimin e stafit ose përdorimin e qendrës. Shërbimi duhet të dokumentoju se nuk ka një konflikt të tillë.</p>

<p>SHSES plotëson nevojat për veshje, gjëra personale të domosdoshme të fëmijëve dhe higjenën e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmijët inkurajohen nga stafi dhe u ofrohet mundësia për të zgjedhur vetë veshjet dhe gjërat e domosdoshme personale, që plotësojnë nevojat e tyre. - Fëmijët nuk veshin rroba të përdorura të njëri tjetrit (në rast se janë më shumë se një fëmijë në SHSES). - Fëmijët kanë hapësira në dhomat e tyre të gjumit për të mbajtur rrobot. - Stafi shoqëron fëmijën për çdo veprim higiene. - SHSES përdor ditarë⁶ ditore ose në dosjet personale për secilin fëmijë shprehen shërbimet e ofruara dhe të marra nga fëmija (Zakonisht me punonjësi përgjegjës i fëmijës etj). 	<p>Punonjësi përgjegjës për fëmijën siguron higjenën e fëmijës dhe veshjen e tyre sipas grupmoshës dhe nevojës. Çdo shërbim i ofruar regjistrohet në ditarin ditor ose në dosjen personale të fëmijës sipas formës.</p>
<p>Fëmijët marrin një dietë të shëndetshme, ushqyese sipas nevojave të tyre të rritjes dhe zhvillimit dhe nevojave kulturore, fetare, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Janë plotësuar kushtet lidhur me shëndetin, higjenën, përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimeve - Ekziston një menu që i përshtatet moshave të fëmijëve, nevojave te tyre për lëndë ushqyese dhe kalori dhe një menu për fëmijët me nevoja dietore të veçanta - Kontratë për shërbimin e ushqimit në rast se këto shërbime janë të kontraktuara jashtë SHSES dhe janë specifike. - Stafi ka njohuri për nevojat dhe teknikat e ushqimit si edhe çrrregullimet në të ngrënë tek fëmijët. - SHSES ka një ambient ngrënje ku mobiliet dhe pajisjet i përshtaten parametrave bashkëkohorë të sigurisë, cilësisë, si dhe numrit, nevojave dhe moshës së fëmijëve. - Prosesverbalet ekontrollit dhe rezultatet e kontrollit nga strukturat e shëndetit publik, bashkia dhe Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror. 	<p>Stafi përgjegjës siguron që fëmijët ushqehen sipas një menuje të shëndetshme në përputhje me nevojat dhe grupmoshën e fëmijës në një ambient të përshtatshëm duke e shoqëruar fëmijën gjatë procesit të ushqyerjes.</p>
<p>Fëmijët i nënshtrohen vlerësimi te nevojave shëndetësore dhe SHSES plotëson me shërbime shëndesore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të dhëna të regjistruara në SHSES, dëshmojnë se çdo fëmije i është nënshtuar vlerësimi të parë të nevojave mjekësore (kontrolleve mjekësore) në qendrën shëndetësore më të afërt ose në ambientet e qendrës. - Stafi përgjegjës shoqëron fëmijën për kryerjen e kontrollit mjekësor në rastet kur ky vlerësim kryhet jashtë ambienteve të qendrës. 	<p>Fëmijët e vendosur në SHSES duhet të kryejnë dy analiza kryesore ajo e HIV-Aids dhe e tuberkulozit, të nevojshme edhe për vendosjen e fëmijës në strehëza rezidenciale (në rastet e vendosjes sipas masës së mbrojtjes), të cilat shoqërohen me një paketë ekzaminimesh të rekomanduara nga personeli</p>

⁶ Fleta e ditarit gjendet në aneks 7

		shéndetësor.
SHSES ka një program të strukturuar me aktivitete që lidhen me edukimin dhe kohën e lirë përfmijët në përputhje me grupmoshën e tyre dhe nevojat e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> - Janë te disponueshme programe te kohës se lire dhe edukimit, te cilat përfshihen në informacionin që u jepet fëmijëve sipas moshës, fesë, kulturës, dëshirave të fëmijës. - Ka të dhëna përfmijët në lidhje me edukimin ose lojra në kohën e lirë. Ndërkohë këto të dhëna tregojnë përfshirjen e fëmijëve. - SHSES zoteron paisje, lodra, mjete dhe ambientet përfmimin e aktiviteteve. 	<p>Strehëza duhet të ketë listën e specialistëve që ofrojnë shërbime specifike si përkthyesh përfituesit e huaj/ minoritet, logoped, animator social, njoħeš së gjuhës së shenjave, etj, të cilët mund tē jenë tē kontraktuar ose janë tē gatshëm tē ofrojnë këtë shërbim sa herë tē jetë e nevojshme në çdo kohë.</p> <p>Stafi i edukimit dokumenton në dosjet përkatëse realizimin e aktiviteteve dhe rezultatet per çdo fëmijë.</p>
Fëmijët e vendosur në SHSES marrin shërbim psikologjik në përputhje me nevojat e fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> - Të dhëna tē regjistruara në SHSES, dëshmojnë se çdo fëmije i është nënshtuar vlerësimit psikologjik nga psikolog dhe merr trajtim për problematikat specifike individuale nëpërmjet seancave të këshillimit apo terapive të ndryshme. 	<p>Çdo shërbim tē jetë i shoqëruar me aneksin shpjegues përkatës.</p> <p>Çdo profesionist dokumenton shërbimet e veta, nëpërmjet formave të përcaktuara tē vlerësimit, planifikimit tē ndërhyrjeve, aplikimit te terapive, etj</p>
Fëmijët e identifikuar në rrezik tē menjëherëshëm dhe tē vendosur në SHSES shoqërohen ⁷ me mjete transporti tē sigurt dhe me staf përgjegjës.	<ul style="list-style-type: none"> - Mjete transporti tē disponueshme përfmijëve e procesin e intervistimit, vlerësimit mjekësor, seanca gjyqësore, takime me familjarë, terapi, etj - Staf përgjegjës përfmijëve e fëmijës, përfmijët tē cilin ka një plan lëvizje bazuar në nivelin e rrezikut dhe mbrojtjes, protokollin e lëvizjes dhe masat e ndërmarrja. 	Dokumentim në dosjet e fëmijëve dhe format përkatëse mbi lëvizjet, kohën, qëllimin dhe rezultatin e arritur.

⁷ Proces verbal i shoqërimit tē tē miturve gjendet në aneks 16 dhe i shoqërimit tē familjes gjendet në aneks 17

Standardi 3: Pranimi i fëmijës, vlerësimi i nevojave dhe plani i ndërhyrjes përfëmijën

SHSES harton një plan të ndërhyrjes përfëmijën, në bashkëpunim me fëmijët/përfituesit e rritur të shërbimeve pasi fëmija është pranuar, (në përputhje me moshën dhe të kuptuarin e fëmijës) dhe aktorët e tjerë të përfshirë në masën e mbrojtjes. Në plan përshkruhen qartë nevojat e vlerësuara të fëmijës/përfituesit, burimet dhe veprimet që nevojiten përfshirë t'i zgjidhur ose përmbytshur këto nevoja.

Rezultati i dëshiruar: Nevojat e fëmijëve/përfituesve të shërbimeve të jenë vlerësuar plotësisht dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës dhe nevojave të tyre, në funksion të hartimit të planeve individuale të ndërhyrjes dhe përkujdesit.

Kriteret	Treguesi i cilësisë	Udhëzime
SHSES mund të ofrojë shërbime mbrojtje vetëm në rastet e një emergjencë që përbën një rrezik të menjëhershëm përfshirë fizik, psikologjik ose sigurinë e fëmijës. ⁸	<ul style="list-style-type: none"> - SHSES duhet të ketë politika të shkruara të pranimit⁹ që specifikojnë moshën, gjininë dhe llojin e problematikave të cilat ju kanosen fëmijëve dhe që mund të përfitojnë nga ky shërbim. - Një kopje të politikave të pranimit duhen dorëzuar në institucionin e licencimit kur paraqitet kërkesa e nënshkruar. - Nëse shërbimi i emergjencës miraton një ndryshim në politikat e pranimit që kërkon ndryshime në kushtet e licensës, duhet të aplikojë në institucionin e licencimit përfshirë licencë të re. - SHSES nuk duhet të pranojë më shumë fëmijë sesa numri maksimal i përcaktuar në licensë ose fëmijët mosha dhe gjinia e të cilëve shkelin kushtet e licensës së miratuar. 	
Ekipi multidisiplinar i SHSES ¹⁰ , është përgjegjës përfshirë kryerjen e vlerësimit të nevojave ¹¹ dhe planit të ndërhyrjes përfëmijën e vendosur në SHSES.	<ul style="list-style-type: none"> - Çdo fëmijë ka të plotësuar procesverbalin e hyrjes (pranimit dhe dorëzimit) në SHSES në dosje - Në qendër ka një regjistër të veçantë ku regjistrohen të gjitha hyrjet dhe daljet e fëmijëve në qendër - Ekipi multidisiplinar njeh përgjegjësitë 	Pas plotësimit të formularit të hyrjes, është mirë që formularët e tjerë mbi nevojat të plotësohen në një moment pasi fëmija/përfituesi të jetë orientuar me ambientet e SHSES dhe t'i jenë plotësuar nevojat jetësore bazë, si

⁸ Sipas VKM 578/2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve përfshirë zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes"

⁹ Formati e pranimit gjendet në aneks 2 dhe 3

¹⁰Ekip multidisiplinar nënkuption një ekip të përbërë nga punonjës social, psikolog, mjek, mësues, edukator, jurist që ofrojnë shërbime pranë SHSES

¹¹ Formati i vlerësimit të nevojave gjendet në aneks 4 dhe formati i identifikimit të rrezikut në aneks 5

	<p>Iidhur me vlerësimin dhe planifikimin e ndërhyrjes</p> <ul style="list-style-type: none"> - Secili fëmijë ka një plan te vetin - Vlerësimi i nevojave dhe Plani i ndërhyrjes fillon që në momentin e marrjes së fëmijës në mbrojtje dhe vendosjen e tij në SHSES - Janë përcaktuar objektiva të qarta për veprime dhe personi përgjegjës për realizimin e vlerësimit të nevojave dhe planit të ndërhyrjes me afate kohore konkrete nga 24 orë në 28 ditë 	<p>higjenë, veshje, ushqim, trajtim mjekësor (nëse ka nevojë).</p>
Vlerësimi i nevojave të fëmijës në situatë emergjente duhet të kryhet brenda 72 orëve, duke u pasuar me vlerësime specifike sipas çdo rasti, sipas Aneksit 6	<ul style="list-style-type: none"> - Ka formate të përcaktuara vlerësimi, të cilat janë të përshtatura sipas moshës - Ka prova (dëshmi) që vlerësimi i nevojave janë diskutuar me fëmijët, që janë kuptuar prej tyre. Shënohen në dokumentet përkatëse fakti kur fëmija/fëmijët nuk bien dakord me to. 	Vlerësimi i nevojave ka formularët përkatës. Pasi bëhet vlerësimi, fëmijës/përfituesi i vihet në dispozicion një dokument i shkruar vlerësimi që ka të bëjë me nevojat e tij të përcaktuara nga grupei multidisiplinare me qëllim që fëmija/përfituesi të informohet që në këtë stad.
Fëmija merr pjesë dhe orientohet të jetë aktiv në ngritjen e planit të ndërhyrjes në bashkëpunim me stafin përgjegjës	<ul style="list-style-type: none"> - Përfshirja e fëmijës në ndërhyrje, dokumentohet - SHSES zotëron teknika dhe instrumenta përkatës për pjesëmarrjen e fëmijëve 	Kjo procedurë ndiqet nga menaxheri i rastit, që mund të jetë punonjës social ose psikolog
Çdo fëmijë, pajiset me një plan ndërhyrjeje ¹² përkujdesi që përfshin aktivitete për kohën e qëndrimit në SHSES dhe përfshin përgatitore të largimit ¹³ nga SHSES	<ul style="list-style-type: none"> - Ka prova (dëshmi) që plani i ndërhyrjes përfshin aktivitete për kohën e qëndrimit në SHSES dhe përfshin përgatitore të largimit nga SHSES - Stafi, fëmija, apo te interesuar te tjerë përfshin aktivitete për kohën e qëndrimit në SHSES, përfshin përgatitore të largimit nga SHSES 	
Plani përfshin aktivitete që ndërtharin ndërhyrjen që në momentin e marrjes në mbrojtje, aplikimit e masës së emergjencës dhe zbatimin e saj, si brenda shërbimit ashtu edhe në referimin në shërbimin e rradhës alternativ.	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i ndërhyrjes përfshin shërbime¹⁴ që janë të rëndësishme përmirësuar e fëmijës dhe sigurinë e tij brenda SHSES, të cilat hartohen nga punonjësi social, mjeku, psikologu, kujdestari, edukatori, etj - Plani i ndërhyrjes parashikon të gjitha nevojat e rezultuara nga procesi i vlerësimit të nevojave me pjesëmarrjen e fëmijës/përfituesit - Plani i ndërhyrjes ndiqet nga personat 	Në planin individual duhet të jenë të përcaktuar qartë, objektivi që synohet në afat kohor të shkurtër dhe të mesëm, aktivitetet që duhen realizuar përmes arritur këtë objektiv, personi apo struktura që do ta realizojë objektivin, koha kur do ta realizojë dhe buxheti që shoqëron çdo aktivitet. Pra, kush? do të bëjë çfarë, përmes arritur

¹² Formati i planit të ndërhyrjes gjendet në Aneks 6

¹³ Formulari i largimit të përfitueses nga SHSES gjendet në aneks 14 dhe i largimit të fëmijës në aneks 15

¹⁴ Sipas pikws 2 tw Aneksit 1

	përgjegjës të përcaktuar në plan sipas afateve kohore të vendosura të mirëpërcaktuara	ku...?.
Ekipi multidisiplinar i SHSES koordinon ndërhyrjen <i>ad hoc</i> me strukturat e mbrojtjes së fëmijës, brenda dhe jashtë shërbimit, jo vetëm me bashkinë por edhe shëndetësinë, policinë, arsimin, gjykatën, etj.	- Ka dokumente qe dëshmojnë se gjatë hartimit të planeve të përkujdesjes apo rishikimit të tyre janë kërkuar informacione nga organizatat e tjera (shkollat, institucionet shëndetësore, OJQ-te e tjera, etj.)	Përfshihen minuta takimi të mbajtura në takime, mbledhje GTN, marrje përgjegjësish, komunikime shkresore, email, etj.

Standardi 4.Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve dhe përfituesve

SHSES nxit dhe praktikon tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin pa bërë diskriminim mbështetur në racën, ngjyrën, kombësinë, gjuhën, gjininë, orientimin seksual, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzënинë, të qenit fëmijë/prind, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitat gjenetike, aftësitë e kufizuara, përkatësinë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera.

Rezultati i dëshiruar: Çdo fëmijë/përfitues i shërbimeve të SHSES gjzon të gjitha të drejtat sipas legjisacionit në fuqi. Fëmija/përfituesi i shërbimit trajtohet me respekt dhe dinjitet. Fëmijët janë të mbrojtur nga të gjitha format e abuzimit apo diskriminimit.

Kriteret	Treguesi i cilësisë	Udhëzime
Hyrja dhe qëndrimi në SHSES kushtëzohet nga masa e mbrojtjes ndërsa largimi prej saj kryhet në përputhje me vendimin e gjykatës, vendimmarrjen e strukturave përgjegjëse të shërbimit social në bashki, rast pas rasti.	<ul style="list-style-type: none"> - SHSES merr çdo fëmijë që ka marrë masën emergjente të mbrojtjes bazuar edhe në kriteret e pranimit - Nëse fëmija nuk është vizituar nga një mjek, dokumentet e pranimit të përfshijnë një hartë trupore dhe nëse është nevoja, fotografi të lëndimeve, të cilat të mund të përdoren më vonë (në rast se fëmija është viktimë e abuzimit) - Fëmija nuk mund ta dalë nga SHSES, vetëm në rastet e vlerësimeve mjekësore ose kërkësës së Komisariatit/Prokurorisë/Gjykatës për vlerësim - Largimi i fëmijës nga SHSES bëhet në përputhje me vendimin e gjykatës ose Strukturës Përgjegjëse për Shërbimet Sociale - Largimi i fëmijës kryhet me miratimin e 	<p>Kopje e masës emergjente të mbrojtjes ruhet në dosjen e fëmijës pranë SHSES</p> <p>Shpesh, një fëmijë për shkak të rrethanave, nuk vendos t'i drejtohet menjëherë sistemit të drejtësisë penale, por më vonë mund të ndërrojë mendje. Pra, është mirë të ruhen provat për t'ia rritur mundësitetë fëmijës për të raportuar.</p> <p>Në çdo rast ekzaminimi i fëmijës, duhet të jetë i pranishëm edhe psikologu. Asnjëherë nuk duhet vepruar për të bërë foto pa dëshirën e fëmijës. Psikologu</p>

	prindit.	duhet të tentojë bindjen e tij. Është e nevojshme që të pasqyrohet qartë se çfarë ka ndodhur, cilat janë vendimet që lidhen me largimin. Ku do të shkojë, numër kontakti dhe shoqërimi i fëmijës sipas rastit
Çdo fëmijë informohet në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë ¹⁵ gjatë kohës së qëndrimit në SHSES	<ul style="list-style-type: none"> - Fëmija i njeh dhe i ka kuptuar rregullat, detyrimet dhe të drejtat, dhe ky proces është i dokumentuar - Broshurë/fletëpalosje/dokument të afishuar që përfshijnë të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në SHSESO dhe sigurohet që nëpërmjet diskutimeve fëmijët/përfituesit i kuptojnë dhe i gëzojnë të drejtat e tyre. 	Informimi mund të kryhet edhe nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë. E rendësishme është që informimi të realizohet në mënyrë të kuptueshme për të gjithë grupmoshat dhe aftësisë/paaftësisë. Informimi duhet të jetë i dokumentuar në formë në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e fëmijës.
Ekziston një procedurë ankimimi ¹⁶ që bën të mundur bërjen e ankesave nga përdoruesit e shërbimit, fëmijë apo të rritur	<ul style="list-style-type: none"> - Në SHSES gjinden fletushka të thjeshta (instrumenta) dhe të kuptueshme për fëmijët, ose mënyra te tjera te informacionit, që promovojnë procedurat e ankimimit dhe afatet kohore - Ka një dokument që sqaron procedurat e ankimimeve në një gjuhë të thjeshtë dhe të quartë, Kjo, përfshin: kush mund të bëjë ankesë me shkrim ose në mënyrë verbale dhe ku, afatin përfundimtar për një përgjigje dhe organet/personat që do të trajtojnë ankesat etj - SHSES ka një kuti ankesash të vendosur në vend të dukshëm dhe të arritshëm nga fëmijët - Ekziston një person/grup i paanshëm që shqyrton të gjitha ankesat si edhe kanë kompetencën për të filluar veprimet e përshtatshme - Kutia e ankesave hapet një herë në muaj në prani të një grapi të përbërë nga staf, PMF dhe një fëmijë dhe /ose përfaqësues të DRSHSSH - SHSES dokumenton ankesat dhe protokollon format e trajtimit dhe të zgjidhjeve - Rregullorja e SHSES ka një procedurë ankimimi me shkrim dhe verbale, që bën lidhjen me një sistem të jashtëm nëse ankesën nuk e zgjidh SHSES 	<p>Është e domosdoshme të mbahet një bazë të dhëna më vete për të gjitha ankesat e depozitura dhe për zgjidhjen apo mënyrën e trajtimit që u është dhënë.</p> <p>Stafi ka për detyrë të dokumentojë edhe ankesat e shprehura në mënyrë verbale dhe t'i trajtojë me të njëtën procedurë si ankesat me shkrim.</p> <p>Duhet të ketë një procedurë të shpjeguar për hapjen e kutisë së ankesave, ku përfshihet stafi, përfituesit, pmf, periodiciteti i hapjes.</p> <p>SHSES duhet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e procesit të ankimimit, si s.sh kutia e ankesave të jetë në një vend të dukshëm, të arritshëm nga të gjithë (shih nevojat e personave me aftësi të kufizuar) dhe jo nën mbikqyrjen e kamerave.</p> <p>Është mirë të mbahet një bazë të</p>

¹⁵ Informacioni i përbledhur për të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijës gjendet në aneks 10

¹⁶ Përbledhje e procedurave të ankimimit gjendet në aneks 11

	<ul style="list-style-type: none"> - Inspektimi i ankesave të regjistruar tregon se ato janë trajtuar me seriozitet dhe brenda afatit të duhur 	dhënash më vete për të gjitha ankesat e depozituara dhe për trajtiminë zgjidhjesqë iu eshtë dhënë.
Çdo fëmijë/ përfitues të trajtohet si pjesëmarrës në program.	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumentim i pjesëmarrjes së fëmijës/përfituesit në vendimmarrje, në plan ndërhyrje apo takime të organizuar në SHSES në funksion të mirëfunkcionimit të shërbimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve. 	
SHSES ofron kujdes përfituesit që të kenë hapësirën e vet dhe të mundësojë kontrollin e sendeve personale, mijeteve monetare	<ul style="list-style-type: none"> - SHSESH ka një dokument që përcakton qartë detyrat e stafit përfituesit që të kujdesin ndaj fëmijëve (një staf përgjegjës përfituesit që të kujdesin ndaj fëmijëve, por përcaktohet numri i stafit në varësi të grupmoshës, aftësisë së kufizuar, etj) - Në rastet kur fëmija është i shoqëruar me prind, ky i fundit merr përgjegjësi përfituesit që të kujdesin ndaj tij 	Kontratë e nënshkruar më stafin, dhe përshkrimi i punës së tij.

Standardi 5. Të dhënët personale të fëmijës/përfituesit dhe administrimi i tyre

SHSES mbledhin dhe ruajnë të dhënët personale të çdo fëmije/përfituesi, duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale, të vëmendshme dhe në funksion të mbrojtjes së tyre. SHSES krijon kushtet në mënyrë që administrimi i të dhënave të bëhet në përputhje me normat ligjore dhe të mbështetet në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit.

Rezultati i dëshiruar: Të drejtat dhe interesi më i lartë i përfituesve të shërbimeve mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënët e kësaj natyre dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e SHSES, përfituesit që t'ju ruajtjan e mbrojtjen e të dhënave.

Kriteret	Treguesi i cilësisë	Udhëzime

<p>Çdo fëmijë ka dosjen e tij/saj individuale, me një format të unikuar, ku ruhen të gjitha dokumentet, planet dhe informacionet</p>	<p>Dosja të përbajë çdo dokument të nevojshëm që vërtetojnë masën e emergjencës, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - raportin e policisë për evidentimin dhe trajtimin e rastit; - masën emergjente të mbrojtjes të miratuar sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; -urdhérin e lëshuar nga gjykata për vendosjen e fëmijës në shërbim emergjencë; -dokumente të tjera që do të gjykojnë të përshtatshme për të identifikuar fëmijën në rrezik të menjëhershëm të siguruar nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve; -formularët e pranimit, të vlerësimit të nevojave, planin e ndërhyrjes, çdo dokument tjetër ndihmues. 	<p>Dosja pasurohet në mënyrë të vazhdueshme. Jo vetëm më formularët e cituar, por edhe me komunikimet shkresore, email, minuta takimi, raporte vlerësimi nga çdo specialist, etj</p>
<p>SHSES ka të përcaktuar qartë se çfarë përfshihet në të dhënat personale dhe ka një sistem që siguron ruajtjen, konfidencialitetin dhe arkivimin e të dhënavë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të dhënat personale mbahen në dosje të mbyllura dhe ruhen në kompjuter, të mbrojtura me fjalëkalim nga personi përgjegjës - Dosja të jetë kofidenciale dhe të mund të shihet vetëm nga fëmija/prindi në rastet kur është me të dhe punonjësi social dhe/ose menaxheri i rastit dhe/ose koordinatori i qendrës - Për identifikimin e fëmijës/përfituesit në dosje të përdoren iniciale ose një kod i caktuar. 	<p>Të dhëna konfidenciale personale të përfituesit, procedurat se si ato duhet të përdoren dhe personat të cilët do të kenë akses në to, përcaktohen në rregulloren e brendshme të SHSES</p>
<p>Brenda kuadrit të tipologjisë së shërbimeve, ofruesi i shërbimit duhet të marrë nga fëmija/përfituesi informacionin më të domosdoshëm, i cili e ndihmon atë në punën me përfituesin</p>	<p>Të gjitha të dhënat më te rëndësishme të fëmijës/përfituesit.</p>	<p>Brenda stafit ka personel te trajnuar, i cili e trajton informacionin e përfthuar sipas parimeve të konfidencialitetit, sigurisë, mbrojtjes së te dhënavë të fëmijës/përfituesit, rregullimeve ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim etj.</p>
<p>SHSES të ketë rregulla të përcaktura në lidhje me reagimin ndaj ftesës për të dëshmuan dhe urdhreve gjyqësore.</p>	<p>Rregullorja e institucionit</p>	<p>SHSES duhet të diskutojnë dhe të vendosin paraprakisht se deri ku duhet të shkojnë për të mbrojtur fshehtësinë e të dhënavës dhe për të mos i dorëzuar dosjet edhe kur këtë ua kërkojnë organet zyrtare. Organet e forcave të ligjit nuk kanë lirishikimi të informacionit pa urdhër të gjykatës, për të cilin SHSES i jepet kohë e mjaftueshme për t'u përgjigjur.</p>

Fëmija/Përfituesi ka akses në dosjet dhe të dhënat e tij individuale.	Fëmija/Përfituesit konfirmojnë se ata kanë patur akses në dosjet e të dhënat e tyre individuale.	Fëmijës/Përfituesit duhet t'i jepet mundësia ta shohë dosjen, nëse stafi vendos për arsyen e sigurie të mos lejojë aksesin e fëmijës në dosje duhet të konfirmohet nga administratori që do të ishte e dëmshme një gjë e tillë
Fëmija/Përfituesi është i informuar që informacioni në dosjen e tij/saj mund t'u vihet në dispozicion autoriteteve ligjore	Fëmija/Përfituesi është i informuar qartë për ndarjen e informacionit me autoritetet ligjore kur: <ul style="list-style-type: none"> - një gjë e tillë i kërkoitet SHSES nga autoritetet ligjore; - SHSES në bazë të Kodit Etik dhe të ligjeve në fuqi e vlerëson se ka një situatë rreziku përfituesin apo për një person tjetër - Në dosje duhet të ketë një formular¹⁷, ku të jepet arsyja e njoftimit dhe logjika mbështetëse e saj. 	Mbahet një bazë të dhënash për të gjitha kërkesat për të shikuar dosjen. Nëse hidhet poshtë kërkesa, është mirë të shprehet qartë arsyaja dhe të përfshihet në dosje.

¹⁷ Formulari i miratimit për ndarjen e informacionit gjendet në aneks 8

¹⁸ Formulari i raportimit për fëmijën në nevojë për mbrojtje gjendet në aneks 13

Të dhënat e përfituesve të ruhen dhe të mbahen për aq kohë sa parashikon legjislacioni në fuqi.	SHSES ka një ambient të caktuar për ruajtjen e dokumentacionit dhe një praktikë për asgjesimin e tij, në bazë të ligjit ashtu si edhe ruajtjen në kompjuter	Pas përfundimit të periudhës së parashikuar në ligj këto të dhëna arkivohen. Pas kësaj periudhe të dhënat më të rëndësishme për çdo përfitues ruhen në formë kompjuterike ndërsa dokumentet në formë të shkruar asgjësohen
---	---	--

Standardi 6. Menaxhimi dhe administrimi i brendshëm i SHSES

SHSES siguron mekanizmat e duhur formal të administrimit të brendshëm për funksionimin e qendrës dhe ekzekutimin e shërbimeve që ofron.

Rezultati i dëshiruar: Përmes administrimit të brendshëm, ofruesit e shërbimeve të sigurojnë shërbim dhe funksionim eficent për të arritur qëllimin, vlerat dhe parimet e praktikës më të mirë në terren, në funksion të interesit më të lartë të fëmijës.

Kriteret	Treguesi i cilësisë	Udhëzime
Ofruesi i shërbimeve të ketë strukturën e nevojshme dhe stafin e kualifikuar/me përvjoë për të realizuar shërbimet. Stafi duhet të përfshijë një kordinator dhe një staf të aftë teknik, për të siguruar shërbime me cilësi të lartë dhe /ose staf administrativ dhe mbështetës për të siguruar realizimin e shërbimeve me cilësi të lartë.	<ul style="list-style-type: none"> - Organograma e ofruesit të shërbimeve, që përcakton qartë pozicionet e stafit dhe lidhjet hierarkike ndërmjet tyre - Dosjet individuale të anëtarëve të stafit që përfshijnë: CV, diplomë, dëshmi penaliteti, kopje të kualifikimeve, rekomandime, trajnime, përshkrimin e vendit të punës dhe vlerësimin e bërë për stafin, libreza shëndetësore për çdo punonjës të stafit. Përshkrimi i punës dhe kontrata firmosën nga drejtuesi i SHSES dhe punonjësi i kontraktuar - Çdo staf është i njojur me përshkrimin e punës dhe rolin e tij në SHSES 	I gjithë stafi duhet rekrutuar nëpërmjet një konkursi të hapur dhe punësimi është në përputhje me arsimin përkatës, në bazë të kualifikimeve të tyre, aftësive dhe eksperiencës. Marrëdhëniet juridike individuale të punës, të personelit duhet të parashikojnë të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore të legjislacionit të punës. Konfirmimi për zbatimin me përpikëri të këtij kriteri dhe për saktësinë e treguesit duhet të kërkohet edhe nga anëtarët e stafit dhe/ose aty ku është e mundur edhe nga përfituesit
Staf i përshtatshëm për nevojat e fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> - Secili punonjës i ri të trajnohet nga ofruesi i shërbimeve ose nga ndonjë person tjetër dhe/ose në bashkëpunim me MSHMS, në mënyrë të veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve. Ofruesi i shërbimeve të sigurojë trajnim të vazhdueshëm profesional dhe teknik të stafit, në përputhje me nevojat - Të dokumentohet kualifikimi i stafit për çdo trajnim dhe një kopje të vendoset në dosjen e punonjësit 	Është shumë e rëndësishme përzgjedhja e kujdeshme e trajnitit, për të ruajtur filozofinë e shërbimit, që është siguria, mbrojtja e fëmijëve dhe fuqizimi i përfituesve/ familjeve të tyre.

SHSES ka një sistem vlerësimi për stafin në mënyrë periodike	<ul style="list-style-type: none"> - Procedura dhe kriteret e vlerësimit në manual dhe vlerësimet në dosjet e stafit - Të aplikohet praktika e testimit për stafin një herë në vit 	<p>Vlerësimet e stafit të bëhen dy herë në vit dhe të konsistonë në vlerësime 360 gradë, domethënë kërkesa për marrjen e mendimeve nga të gjithë kolegët në ofruesit e shërbimeve.</p> <p>Është e rëndësishme të parandalohet qarkullimi i stafit dhe të mbahet stafi nëse ka një shkallë karriere për punonjësit. Pra, është e rëndësishme për vlerësimin që punonjësit të mund të ngrihen në përgjegjësi brenda së njëjtës organizatë ose nga njëra organizatë në tjetërën.</p>
SHSES siguron mirëqenien shëndetësore dhe emocionale të stafit nga elementët e mbingarkesës permanente dhe të konsumimit profesional (<i>burn out</i>) nëpërmjet supervizimit individual të ofruar nga persona të jashtëm, nëpërmjet takimeve me psikologë, këshillimet në grup ose diskutimet mes profesionisteve, të paktën 2 herë në vit.	<ul style="list-style-type: none"> - Supervizim individual, këshillimet në grup ose diskutimet mes profesionistëve që provojnë se janë realizuar sipas nevojave të stafit. Programet, plani i veprimit, fleta e vlerësimit të bërë 	<p>Stafi, që ka ndekur këto seanca ka reduktuar ngarkesën emocionale, ndihet më i lehtësuar, ka adresuar çështjet e konsumimit profesional, etj</p>
SHSES duhet të ketë një sistem përfundimin financiar të tij. Buxheti i ofruesit të shërbimit duhet të jetë real, transparent, i verifikueshëm dhe i disponueshëm në çdo kohë. Veprimet financiare te ofruesit të shërbimit janë të dokumentuara dhe të justifikuara	<ul style="list-style-type: none"> - Veprimet financiare të institucionit duhet të janë të disponueshme për efekt inspektimi dhe auditimi nga autoritetet përgjegjëse 	
SHSES vendos procedura përfundimin financiar të tij në lidhje me hyrjen e fëmijës/përfituesit, jetën e tij aty, daljen nga shërbimi, evidentimin e ushtrimit të dhunës apo abuzimit	<ul style="list-style-type: none"> - SHSES ka dokumente për çdo procedurë si rregullore të brendshme, regjistra ku regjistrohen të gjitha hyrjet dhe daljet e efëmijëve nga SHSES, marrëveshje, masat që merren përfundimtari i evidencave të dhunës, abuzimit, etj 	

Standardi 7. Siguria e përfituesve të shërbimeve dhe e stafit

Ofruesi i shërbimeve të marrë masat për sigurinë e stafit dhe të fëmijëve/përfituesve. SHSES të mbahet i paprekur dhe të ruhet fshehtësia e vendndodhjes së tij në çdo kohë. Çdo ofrues shërbimi të përcaktojë qartë mënyrat e trajtimit të situatave emergjente dhe të rreziqeve.

Rezultati i dëshiruar: Stafi dhe fëmijët të ndjehen të sigurt dhe jo të kërcënuar për jetën e tyre dhe të personave të tjerë në mjetet e SHSES. Ofruesi i shërbimeve i administron në kohë situatat emergjente në mjetet e tyre.

Kriteret	Treguesi i cilësisë	Udhëzime
Ofruesi i shërbimeve të bëjë një vlerësim të plotë dhe profesional të sigurisë së mjetave të brendshme dhe të mjetave të jashtëm ku do të strehohen përfituesit, përpala se të vendosë për ta hapur shërbimin	Dokument në dosje, nga personeli i vlerësimit të sigurisë.	Është mirë që ky vlerësim të bëhet çdo vit.
Ofruesi i shërbimeve të ketë një marrëdhënie të vazdueshme me komisariatin më të afërt të policisë për të siguruar mbrojtje në situata emergjente	Dokument në dosje, një akt marrëveshje me komisariatin më të afërt të policisë.	Sidomos nëse SHSES vendos të ketë adresë publike, është jetike të ketë marrëdhënie me forcat e ligit për të siguruar një reagim të shpejtë. Ofruesi i shërbimeve garanton ruajtjen e objektit me shërbime të specializuara.
Ofruesi i shërbimeve të trajnojë punonjësit për çështjet e sigurisë dhe masat përkatëse për të siguruar sigurinë në rastet që paraqesin rrezik ndaj përfituesve dhe vetë stafit.	Modul trajnimi Dokumentimi i trajnimeve të zhvilluara	Moduli i trajnimit mund të përfshijë: Teknikat bazë të vetëmbrojtjes për stafin dhe, mbase, edhe për përfituesit; Ndërgjegjësim për ndihmën e shpejtë për stafin e strehëzave dhe për stafin jo mjekësor; Ndërgjegjësim për mënyrën e reagimit me raste specifike si përdorues të lëndëve narkotike, alkolit, përfitues me probleme të shëndetit mendor; Ndërgjegjësim për vlerësimin e sigurisë dhe rreziqeve, edhe nga shkaqë natyrore. Diskutime të rregullta me stafin për incidentet kur stafi ose përfituesit janë ndjerë të frikësuar dhe se si mund të parandalohen situata të tilla në të ardhmen.
Ofruesi i shërbimeve duhet të ketë një protokoll të qartë veprimi për	- Dokumenti i protokollit është i afishuar, i aksesueshëm dhe i njohur	Protokoli duhet të ndahet me të gjithë

rastet e largimit pa leje tefëmijëve/përfituesve	nga stafi dhe fëmijët	aktorët e përfshirë. Lista e numrave të telefonit, personat e kontaktit, etj.
--	-----------------------	--

Standardi 8. Vlerësimi i shërbimeve të ofruara nëpërmjet inspektimit dhe monitorimit

Ofruesi i shërbimeve monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike cilësinë e shërbimeve të ofruara, për të rritur cilësinë e shërbimit të ofruar.

Rezultati i dëshiruar: Shërbime të cilësisë së lartë përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës.

Kriteret	Treguesi i cilësisë	Udhëzime
Secili ofrues i shërbimeve të ketë strukturën e vet të cilës t'i jetë ngarkuar detyra e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, duke mbajtur në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimeve që duhen përbushur	Personat përgjegjës përmes monitorimin dhe vlerësimin janë -staf i shërbimeve shoqërore në Bashki -Inspektoriat i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror	
Ofruesi i shërbimit ka ndërtuar një sistem përmes monitorimin e zbatimit të procedurave	Ka dokumentacion ¹⁹ (proces-verbale, protokolle etj.) që regjistron zbatimin e procedurës së monitorimit	
Raportet e monitorimit dhe vlerësimit diskutohen në strukturat përkatëse menaxhuese si dhe me stafin dhe çojnë në përshtatjen e aktiviteteve nëse është e nevojshme	Shënimet nga mbledhjet në të cilat janë diskutuar raportet e monitorimit dhe vlerësimit	
Përfituesit janë të përfshirë në procesin e monitorimit. Çdo raport monitorimi dhe vlerësimi duhet të marrë parasysh opinionin e personave që kanë përfituar nga shërbimet e ofruara	Mendime dhe pyetësorë të plotësuar nga përfituesit e mëparshëm, intervista dhe fokus grupe me përfituesit dhe aktorët e tjera	

¹⁹ Formulari i vlerësimit të shërbimit gjendet në aneks 12

Standardi 9. Buxhetimi i sigurt i shërbimeve të ofruara në shërbimin e emergjencës

Ofruesi i shërbimeve duhet të sigurojë shërbime cilësore, bazuar në buxhet të garantuar për çdo shërbim dhe staf të përfshirë.

Rezultati i dëshiruar: Çdo shërbim që duhet të ofrohet në qendër, duhet të jetë i siguruar me një buxhetim të qëndrueshëm të paktën pér një vit kalendarik, përpara se të fillojë të funksionojë si qendër.

Kriteret	Treguesi i cilësisë	Udhëzime
Çdo shërbim që duhet të ofrohet në qendër, duhet të jetë i siguruar me një buxhetim të qëndrueshëm të paktën pér një vit kalendarik, përpara se të fillojë të funksionojë si qendër.	Buxhet i miratuar nga Bashkia ose donatorë	Bashkia duhet të sigurojë vazdimësi të shërbimit nëpërmjet sigurimit të fondeve si nga buxheti i saj, ashtu edhe nëpërmjet bashkëpunimit me organizata jofitimprurëse, të cilat kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve.

1. Deklarata e qëllimit

1.1. Çdo qendër e licensuar për shërbimet e strehimit emergjent tësigurtë (SHSES) për fëmijë, publike dhe jopublike, harton një dokument përbledhës, ku të përshkruhet qartë dhe thjeshtë misionin e qendrës, shërbimet që ofron, qëllimet dhe objektivat e saj.

1.2. Në dokumentin përbledhës të ofruesit të shërbimit përcaktohet:

- misioni,
- objektivat e qendrës,
- profili që ka, liçensimin për shërbimin, planimetrinë e objektit ku të jenë të përcaktuara qartë ambientet me funksionin përkatës, në formë shkresore të dhëna që të vërtetojnë pronësinë/kontratë qeraje dhe qëndrueshmëria mbi objektin ku zhvillohet aktiviteti,
- shërbimet që ofrohen, kriteret për të përfituar këto shërbime,
- struktura organike e stafit të qendrës për zbatimin e shërbimeve të deklaruara, detyrat dhe detyrimet e tyre,
- procedurat e shërbimeve,
- mbrojtja dhe siguria e përfitueseve, lidhja me familjarët dhe të afërmit, lidhja me strukturat përkatëse të mbrojtjes
- procedura e ankimimit,
- deklarata e konfidencialitetit,
- referimi në një strehëz/ shërbim tjetër apo largimi nga qendra.

1.3. Misioni, vizioni, qëllimet dhe objektivat afishohen në një vend të dukshëm dhe të disponueshëm për të gjithë stafin dhe përfituesit (fëmijët dhe/ të rriturit që i shoqërojnë) dhe janë të hartuara në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për grupmoshën e fëmijëve, si edhe për fëmijët me aftësi të kufizuar. Një dokument i tillë duhet të jetë i hartuar edhe në gjuhën e shenjave, përfshirë dhe alfabeti breil.

1.4. Fëmijë/përfitues apo të rritur duhet të sigurohen se ndodhen në një ambient të sigurtë dhe të qetë se janë njojur me dokumentin përbledhës të ofruesit të shërbimit dhe kanë marrë një kopje të tij. Për fëmijët nën 14 vjeç, duhet të përdoren instrumenta të caktuar që të dokumentojnë marrjen në dijeni të shërbimeve të ofruara. Stafi siguron për çdo fëmijë/përfitues informacion lidhur me funksionimin e SHSES ose të shërbimeve që do t'i ofrohen fëmijës.

1.5. Dokumenti përbledhës i ofruesit të shërbimeve duhet të ketë të shprehur qartë se si ofrohen shërbimet, drejtpërdrejt nga ofruesi i shërbimeve ose nëpërmjet referimit nga institucionet ose organizatat e tjera. Shërbimet duhet të janë të specializuara për fëmijë dhe të ofrohen nga një staf i specializuar sipas çdo shërbimi. Në rast se këto shërbime ofrohen nga palë të kontraktuara jashtë qendrës, duhet të dokumentohet kontrata e shërbimit si dhe lista e specialistëve të licensuar, që janë në dispozicion për të ofruar ndihmë në shërbimin e emergjencës 24/7 ditë të javës. Në dosjen e përfituesve mund të disponohet një kopje e kontratës së shërbimit si dhe dokumenti i politikave të mbrojtjes së fëmijëve i firmosur. Çdo shërbim shoqërohet me udhëzime të qarta sqaruese mbi mënyrën e ofrimit të tij, duke filluar nga cilësia e ushqimit, dieta ditore për çdo fëmijë, hapësira e akomodimit, kushtet e përshtatshme për të siguruar higjenë të pastër, lavanderia, kuzhina, hapësirat për lojë brenda dhe jashtë ambientit të qendrës, etj.

1.6. Duke qënë se pjesëmarrja në SHSES, është një masë e ndërmarrë nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, të cilat mund të janë të shoqëruara edhe me vendim gjykate, mund të parashikohen rastet kur fëmijët mund të janë të shoqëruar nga kujdestarët e tyre ligjore/prindërit, të cilët për një arsy ose tjetër mund të mos janë dakort për qëndrimin në këtë shërbim. Vetëm për këtë kategori përfituesish, duhet të ketë një deklaratë pranimi, e cila të përfshijë dhe largimin vullnetar nga strehëza SHSES. Për të miturit nën 18 vjeç, të pashoqëruar, ose kur janë prind fëmijë me fëmijë në qendër, qëndrimi në shërbimin e emergjencës do të jetë në varësi të urdhrit /vendimit të marrë nga strukturat përkatëse, pavarësisht dëshirës së tyre. Stafi i qendrës ka për detyrë të shpjegojë dhe lehtësojë situatën për çdo fëmijë që nuk ndjehet i qartë apo konfort me situatën.

1.7. Dokumenti përbledhës i ofruesit të shërbimit rishikohet dhe përditësohet sa herë që ofruesi i shërbimeve zgjeron aktivitetin e tij, por që asnjëherë nuk del jashtë objektit të licensimit të qendrës. Në këtë proces, ndër të tjera ndihmojnë dhe proces verbalet e kontrolleve të kryera, rezultate e kontrollit nga strukturat e shëndetit publik, bashkia dhe inspektoriati i shërbimeve sociale.

2. Llojet e shërbimeve

2.1 Kriteret e shërbimeve

SHSES nuk duhet të ofrojë, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin objekt, dy lloje kujdesi që bien ndesh me interesin më të lartë të fëmijëve, përdorimin e stafit ose përdorimin e qendrës. Shërbimi duhet të dokumentojë se nuk ka një konflikt të tillë.

2.2 Shërbime ditore

- SHSES duhet të zhvillojë orar të dizenuar ditor për të përbushur nevojat e fëmijëve;

- Personeli i kujdesit pér fëmijët duhet tē mbajë një regjistër të ngjarjeve të rëndësishme pér secilin fëmijë. SHSES duhet ta mbajë këtë regjistër ne dispozicion tē stafit dhe Inspektoriatit;
- SHSES duhet tē pérmbushë nevojat e menjëherershme tē fëmijëve;
- SHSES duhet tē bëjë konsultime dhe trajnime tē specializuara pér fëmijët me nevoja urgjente tē veçanta. Kur jepen shërbimet, ato duhet tē dokumentohen në dosjen e fëmijës, se ai/ajo i ka marrë ato;
- SHSES duhet tē sigurojë që çdo fëmijë tē furnizohet me veshje personale tē përshtatshme pér moshën dhe fizikun e fëmijës. Gjithashtu duhet tē sigurojë që veshja është e krahasueshme me veshjet e fëmijëve tē tjerë në situata normale. Fëmijët duhet tē kenë disa alternativa në zgjedhjen e veshjeve tē tyre;
- SHSES duhet t'u japë fëmijëve trajnime pér kujdesin personal, higjenën dhe duhet ti sigurojë secilit përfitues pajisje pér kujdesin personal dhe higjenën;
- SHSES duhet tē sigurojë aktivitete zhvilluese dhe pajisje mbikqyrëse tē brendshme dhe tē jashtme në mënyrë që çdo fëmijë tē mund tē marrë pjesë dhe tē jetë i monitoruar dhe i mbrojtur nga abuzimet e mundshme;
- SHSES sigurohet që fëmijët janë tē shëndetshëm pérpara se ti përfshijmë ata në aktivitete apo programe mësimore. Duke ofruar shërbim mjekësor dhe udhëzime është forma fillestare pér fillimin e trajtimit tē fëmijëve dhe përfshirjen si pjesë e programeve tē rehabilitimit. Pasi problemet shëndetësore fizike janë ezauruar, ata mund tē përfshihen në një program i ndividual tē strukturuar
- SHSES duhet tē llogarisë paratë personale tē fëmijës tē veçuara nga fondet e tjera tē shërbimit;
- SHSES duhet tē bëjë dallimin midis detyrave që fëmijët pritet tē kryejnë si pjesë e bashkëjetesës dhe përfshirjes së tyre vullnetare në aktivitete ditore.

2.3 Mjedisi fizik

Ofrimi i shërbimeve pranë SHSES është i organizuar në disa hapësira dhe ambiente tē përshtatura me nevojat e fëmijëve në rrezik të menjëhereshëm:

- Ambiente tē qeta dhe tē ndara,
- Maksimizimi i numrit tē fëmijëve që mund tē shfrytëzojnë hapësirat kurdo që shihet si e mundshme,
- Krijimi i hapësirave pér intimitet,
- Krijimi i një ambienti relaksues pér tē qetësuar fëmijët/përfituesit.
- Do ishte më mirë që shërbimi emergjent tē ishte i organizuar në mënyrë tē tillë që fëmijët tē mos ndihen tē zoluar;
- Si rregull i përgjithshëm $2.5m^2 + 5m^2$ është i nevojshëm pér një vend krevati në dhomën e gjumit. Krevatet duhet tē projektohen brenda normave standarde 90cm x 180cm, ata mund tē ndërtohen gjithashtu edhe në varësi tē gjatësisë dhe peshës së fëmijëve.

- Rafte personale dhe të përgjithshme pér vendosjen e veshjeve apo sendeve personale të fëmijëve apo të kenë hapësirën e tyre pér aksesorët personal duhet të jenë pjesë e dhomës.
- Nëse do të ishte e mundshme, do të ishte e udhës që të pengohej drita e diellit në dhomat e gjumit. Fëmijë tē ndryshëm mund tē duan tē flenë apo pushojnë pér një orar të pacaktuar.
- Në varësi tē numrit të fëmijëve të pranuar do të ishte mirë që të krijohej një dhomë e ndarë pushimi ose një zonë e qetë mund tē ishte e nevojshme pér tē lexuar, pushuar, etj;
- Çdo ambient i SHSES duhet tē jetë i pajisur me masat kundër zjarrit dhe vetë strehëza tē ketë një dalje emergjente dytësore;
- Nëse në SHSES akomodohen fëmijë/përfitues me aftësi tē kufizuara, mjediset e qendrës duhet tē aksesoher edhe nga këto fëmijë/përfitues;
- Ofroesi i shërbimeve ka rregulla tē shkruara rreth përdorimit të hapësirave/mjediseve të ndryshme të qendrës. Rregullat shpjegojnë qëllimin e dhomës, kush mund ta përdorë atë, oraret dhe rregullat pér përdorimin e dhomës. Këto rregulla duhet tē hartohen së bashku me fëmijët/përfituesit, me qëllim që çdo fëmijë t'i kuptojë dhe t'i respektojë këto rregulla. Këto rregulla afishohen jashtë se cilës dhomë;
- Zyrat duhet tē përmbajnë pajisjet e nevojshme pér stafin pér tē kryer punën e tyre, duke përfshirë një tavolinë dhe kompjuter, karrige, telefon, raftet e dosjeve, raftet e librave, kasafortë etj. Zyrat e qendrës duhet tē jenë tē mbyllura me çelës gjatë kohës që nuk përdoren;
- Dhoma e këshillimit duhet tē jetë e mbrojtur nga zhurmat dhe tē ketë privatësi në mënyrë që tē sigurohet intimiteti dhe konfidencialiteti i fëmijëve/përfituesve.

2.4 Shërbime shëndetësore

- a) SHSES duhet tē ketë politika dhe procedura tē shkruara pér marrjen e diagnozës dhe trajtimit tē problemeve mjekësore dhe dentare duke kërkuar vëmendje tē menjëherëshme;
- SHSES duhet tē përgatisë kopjet e politikave dhe procedurave dhe ti vendos në dispozicion pér njohje nga përfituesit , si edhe pér shqyrtim nga stafi i licencimit;
- SHSES duhet tē informojë dhe tē trajnojë tē gjithë stafin pér politikat dhe procedurat që duhet tē ndiqen në rast emergjencë;
- b) Gjatë procesit tē pranimit ose sa më shpejt që tē jetë e mundur pas pranimit, SHSES duhet tē marrë informacion mjekësor pér çdo fëmijë duke përfshirë në dosjen mjekësore tē fëmijës informacionin e mëposhtëm:
- Çdo medikament që fëmija po merr;

- Çdo problem shëndetësor kronik, siç janë alergjite e rënda, diabeti, humbja e dëgjimit ose humbja e shikimit ose gjendja shëndetësore e zemrës, etj.
 - Në rast se ky i nformacion nuk është i mundur në momentin e akomodimit të fëmijës dhe situata e tij shëndetësore ka nevojë për ndërhyrje, është detyrë e stafit të qendrës dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijës të koordinohen për të siguaruar këtë i informacion në një kohë sa më të shpejtë.
- c) SHSES duhet të sigurojë dispozita për kujdesin emergjent mjekësor dhe dentar dhe për trajtimin rutinë të problemeve të njoitura kronike shëndetësore;
 - d) SHSES duhet të sigurojë që një fëmijë i sëmurë mund të ndahet nga fëmijët e tjera, në një ambient të përshtatshëm, pa krijuar për asnjë arsy, ndjesinë e diskriminimit;
 - e) SHSES duhet të jetë në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret në lidhje me imunizimin e fëmijëve;
 - f) SHSES duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në lidhje me marrjen, ruajtjen dhe administrimin e barnave;
 - g) SHSES duhet të sigurojë që të dhënat mjekësore përfshijnë i laçet e dhëna, kohën, dozën dhe emrin e personit që administron i laçin.
 - h) Përveçse në rastet kur një fëmijë është duke marrë pjesë në një program vetë-mjekimi të miratuar mjekësor, personeli duhet të kujdeset që të japë të gjitha medikamentet. Personeli i rritur duhet të japë medikamente sipas udhëzimeve në etiketë;
 - i) SHSES duhet të mbajë shënimë dhe dosje mjekësore për secilin fëmijë.
 - j) SHSES duhet të përfshijë në dosje:
 - Një formular të miratimit mjekësor të nënshkruar nga një person i autorizuar. Nëse shërbimi emergjent nuk është në gjendje të marrë pëlgimin me shkrim, duhet të bëjë një shënim në procesverbal. Shërbimi emergjent duhet të marrë pëlgimin me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur pasi ka marrë pëlgimin verbal. Nëse shërbimi i emergjencës nuk është në gjendje të marrë pëlgimin, duhet të dokumentojë në dosjen mjekësore përpjekjet e bëra dhe arsyet pse nuk është marrë;
 - Një procesverbal i provimit të shqyrtimit.

2.5 Ushqyerja, veshja dhe higjiena

SHSES duhet t'u sigurojë fëmijëve ushqim me cilësi dhe në sasi të mjaftueshme në përmbrushje të nevojave për rritje dhe zhvillim.

- SHSES duhet t'u sigurojë fëmijëve një minimum prej tre vakte shërbimës kryesore dhe dy të ndërmjetme, të përditshme.
- Ekziston një menu që i përshtatet moshave te fëmijëve, nevojave te tyre për lëndë ushqyese dhe kalori dhe një menu për fëmijët me nevoja dietore të veçanta; SHSES duhet të mbajë minutë në dosje për një muaj pas përdorimit dhe të ruajë mostrat e ushqimit të çdo vakti deri në 48 orë;
- Stafi ka njoħuri për nevojat dhe teknikat e ushqimit si edhe çrregullimet në të ngrënë tek fëmijët;
- Prosesverbalet e kontrollit dhe rezultate e kontrollit nga strukturat e shëndetit publik, bashkia dhe Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ruhen në dosjet e SHSES;
- Ushqimi mund të sigurohet si shërbim nga vetë strehëza e SHSES, por edhe mund të kontraktohet si shërbim i jashtëm, në varësi të mundësive, infrastrukturës, apo kriterieve të licensimit:
- Kontratë për shërbimin e ushqimit në rast se këto shërbime janë të kontraktuara jashtë SHSES dhe janë specifike.
- SHSES plotëson nevojat për veshje, gjëra personale të domosdoshme të fëmijëve dhe higjenën e tyre.
- SHSES siguron për fëmijët në rrezik të menjëhershëm një lavanderi ku veshjet, mbulesat, shtrojet të mund të lahen. Fëmijët gjithashtu mund të përfshihen në këtë proces si pjesë e të mësuarit apo rehabilitimit;
- Larja mund të jetë pjesë e programit mësimor apo e trajnimit për fëmijët;
- Fëmijët inkurajohen nga stafi dhe u ofrohet mundësia për të zgjedhur vetë veshjet dhe gjërat e domosdoshme personale, që plotësojnë nevojat e tyre;
- Fëmijët nuk veshin rroba të përdorura të njëri tjetrit (në rast se janë më shumë se një fëmijë në SHSES);
- Stafi shoqëron fëmijën për çdo veprim higjiene (për moshën 0-6 vjeç);
- SHSES përdor ditare ose në dosjet personale për secilin fëmijë shprehen shërbimet e ofruara dhe të marra nga fëmija (Zakonisht me punonjësi përgjegjës i fëmijës etj).

2.6 Shërbime edukative dhe argëtuese

Rekreativiteti është e një rëndësie jetësore kur punohet më fëmijë të vendosur në SHSES. Mund të jetë një mundësi e mirë për të krijuar një prezantim të parë, duke ulur barrierat. Gjithashtu mund të ndihmojë në zhvillimin emocional, fizik dhe social. Nuk është e rëndësishme vetëm për ti strehuar fëmijët në qëndër, por edhe ti mbash ata aty nëpërmjet organizimit të aktiviteve që janë me interes për ta. Qendrat ofrojnë për fëmijët aktivitet brenda qendrës, shikim i TV-së, lojra psiko-sociale, aktivitet fizik, etj.

- SHSES ka një program të strukturuar me aktivitete që lidhen me edukimin dhe kohën e lirë për fëmijët në përputhje me grupmoshën e tyredhe nevojat e tyre;

2.7 Shërbimi i transportit

Shërbimi i transportit ofrohet nga një shofer i gatshëm i cili njeh dhe zbaton politikat e mbrojtjes së fëmijëve. Shoferi së bashku me ekipin shoqërues së fëmijës siguron që fëmija është i sigurtë, duke drejtuar i qetë makinën, në shpejtësinë e lejuar dhe duke respektuar rregullat e qarkullimit rrugor. Shoferi shoqëron fëmijën sipas udhëzimeve të dhëna nga ekipi shoqërues i SHSES pranë ambientit të përcaktuar nga Struktura Përgjegjëse për Shërbimet Sociale në Bashki.

3. Pranimi i fëmijës, vlerësimi i nevojave dhe plani i ndërhyrjes përfunduesit

Pranimi i fëmijës

3.1. SHSES mund të ofrojë shërbime strehimi vetëm në rastet e një emergjencë që përbën një rrezik të menjëhershëm për shëndetin fizik, psikologjik ose sigurinë e fëmijës. Informacioni mbi rrezikun e menjëhershëm, situatën në të cilën është marrë fëmija në mbrojtje duhet të dokumentohet në regjistrin e fëmijës.

3.2. Në SHSES mund të pranohen vetëm ata fëmijë të cilët plotësojnë kriteret dhe politikat e ngritura mbi standartet e funksionimit të këtij shërbimi.

- Shërbimi emergjent duhet të ketë politika të shkruara të pranimit që specifikojnë moshën, gjininë dhe llojin e problematikave të cilat iu kanosen fëmijëve dhe që mund të përfitojnë nga ky shërbim. *Një kopje të politikave të pranimit duhen dorëzuar në institucionin e licencimit kur paraqitet kërkesa e nënshkruar.*
 - Nëse shërbimi i emergjencës miraton një ndryshim në politikat e pranimit që kërkon ndryshime në kushtet e licensës, duhet të aplikojë në institucionin e licencimit për një licencë të re.
 - Një shërbim emergjent nuk duhet të pranojë më shumë fëmijë sesa numri maksimal i përcaktuar në licencë ose fëmijët mosha dhe gjinia e të cilëve shkelin kushtet e licensës së miratuar.

3.3. Një shërbim emergjencë nuk mund të mohojë pranimin e fëmijës në qëndër për shkak të përkatësisë etnike.

3.4. Një shërbim emergjencë nuk duhet që me vetëdije të pranojë për kujdes një fëmijë që ka shfaqur sjellje vetëvrasëse ose sjellje të rrezikshme për të tjerët brënda 30 ditëve para pranimit ose të mbajë një fëmijë në kujdes që shfaq nië siellje të tillë përvcese në rastet kur:

- ambjenti fizik i strehës së emergjencës është i tillë që stafi mund të sigurojë vëzhgim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm giatë kohës gjështë e nevoishme:

- shërbimi emergjent siguron që trajtimi mjekësor dhe konsultimi psikiatrik janë në dispozicion 24 orë në ditë nga një mjek i licencuar. Shërbimi duhet të marrë dokumentacion me shkrim për të vërtetuar se trajtimi mjekësor dhe kujdesi psikiatrik janë në dispozicion. Kjo nuk kërkon që mjeku ose psikiatri i licencuar të jetë në stafin e shërbimit emergjent.

3.5. Një fëmijë i çdo moshe mund të qëndrojë në një shërbim emergjence për një periudhë maksimale prej 30 ditësh. Megjithatë, një shërbim emergjent mund të vazhdojë të ofrojë kujdes ndaj një fëmije më pak se pesë vjeç për më shumë se 15 ditë deri në 30 ditë në kujdes nëse ai ka një vëlla ose një prind nën 18 vjeç në strehim emergjent ose nëse vlerësohen se ka arsye të dukshme për vazhdimësinë e kujdesit që është dokumentuar në të dhënrat e fëmijës. Një shërbim emergjent mund të vazhdojë ofrimin e kujdesit ndaj një fëmije pesë vjeçar ose më të rritur për një total prej 30 ditësh në kujdes nëse ekziston një arsy e dukshme për vazhdimësinë e kujdesit që është dokumentuar në regjistrin e fëmijës.

3.6. Arsyet për të cilat mund të vendoset për vazhdimin e kujdesit tej afateve të përcaktuara në masën e mbrojtjes apo vendimin e gjykatës, janë:

- Personi ose agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës ka informuar për nevojën e një shërbimi emergjent gojarisht ose me shkrim, por kërkesat për vendosjen e fëmijës nuk mund të kryhen në kohë për shkak të rr Ethanave jashtë kontrollit të shërbimit emergjent apo tjetër. Shërbimi emergjent duhet të vendosë dokumentacionin me shkrim të marrë nga personi ose agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në dosjen e fëmijës ose të dokumentojë informacionin verbal në dosjen e tij.

Dokumentacioni duhet të përfshijë:

- (a) emrin, adresën dhe numrin e telefonit të strehës ku do të vendoset fëmija;
- (b) specifikat e asaj që nevojiten për të përfunduar vendosjen e fëmijës;
- (c) arsyen, pse kërkesat për akomodim nuk mund të përfundoheshin me kohë;
- (d) datën kur akomodimi do të përfundojë;

- Personi ose agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës ka informuar për shërbim emergjent të menjëherëshëm me gojë ose me shkrim se do ti ofrohet akomodim përfëmijën, por ky akomodim mund të rezultojë i pamundur kështu që një tjetër akomodim alternativ duhet të gjendet për shkak të rr Ethanave, ose pamundësisë për shërbimin emergjent të paracaktuar. Shërbimi emergjent duhet të sigurojë dokumentacion me shkrim apo verbal të marrë nga personi ose agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në dosjen e fëmijës.

Dokumentacioni duhet të përfshijë:

- (a) emrin, adresën dhe numrin e telefonit të strehës ku do të vendoset fëmija;

- (b) arsyen, pse akomodimi nuk mund të bëhet;
 - (c) data ku ky plan nuk u arrit;
 - (d) specifikat, duke përfshirë datat e të gjitha përpjekjeve për të gjetur një akomodim alternativ;
- (3) Fëmija ka nevoja të veçanta dhe personi ose agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës ka informuar për strehim të menjëherëshëm me gojë ose me shkrim se personi ose agjencia përgjegjëse nuk mund të bëjë akomodimin në kohën e përshtatshme për fëmijën për shkak të rrethanave jashtë kontrollit për një shërbim emergjent. Shërbimi emergjent duhet të vendosë dokumentacionin me shkrim dhe informacionin verbal të marrë nga personi ose agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në dosjen e fëmijës.

Dokumentacioni duhet të përfshijë:

- (a) një përshkrim të nevojave të veçanta të fëmijës nga ekspertë të fushës për mbrojtjen e fëmijëve që lidhen edhe me gjëndjen shëndetësore të fëmijës dhe llojin e akomodimit që i përshtatet këtyre nevojave;
- (b) emrat, adresat dhe numrat e telefonit të shërbimeve emergjente të kontaktuara, datën e kontaktit dhe arsyet që këto strehëza nuk mund të ofronin shërbim;

Dokumentacioni i duhur për vazhdimësinë e kujdesit duhet të jetë në dosjen e fëmijës deri në ditën e 16-të që fëmija është në kujdes dhe dokumentacioni i vazhdimësisë duhet të përfshihet në dosjen e fëmijës çdo 10 ditë pas kësaj. Shërbimi emergjent duhet ta ketë këtë dokumentacion të disponueshëm për shqyrtim nga stafi i licencimit.

3.7. Nëse fëmija është nën kujdesin emergjent për më shumë se 15 ditë, shërbimi i emergjencës duhet të ketë një plan të shkruar për masat që janë marrë ose duhet të merren nga strukturat përkatëse të Mbrojtjes së Fëmijës/ Gjykata, për zhvendosjen e kujdestarisë së përkohëshme të fëmijës nga personi ose agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës, nëse ka.

3.8.. Shërbimi i emergjencës duhet të përcaktojë në politikat dhe procedurat e saj se cili nga stafi do të caktohet që të shqyrtojë informacionin e pranimit dhe të japë pëlqimin për akomodimin.

3.9. Kur fëmija pranohet edhe pse nuk i plotëson kushtet për të marrë shërbimin e strehimit emergjent, shërbimi i emergjencës duhet të përpinqet të kontaktojë kujdestarin proceduriale të fëmijës ose prindërit brenda 24 orëve, nëse shërbimi i emergjencës e njeh identitetin e prindërvë vihet menjëherë në kontakt me ta. Nëse prindërit ose kujdestari procedural nuk mund të kontaktohen, stafi i strehës duhet të njoftojë një agjenci publike (siç janë Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Shërbimin e Provës për të mitur ose dhe policinë) për praninë e fëmijës në strehën e emergjencës. Shërbimi i emergjencës duhet të dokumentojë përpjekjet e bëra për

të kontaktuar prindërit fëmijës, kujdestarin proceduriale apo edhe kontaktet me agjencitë në dosjen e fëmijës.

3.10 Shërbimi i emergjencës duhet të ofrojë orientim për fëmijët e sapo pranuar.

Vlerësimi i nevojave

3.11. Nevojat e fëmijëve të dhunuar/ të marrë në mbrojtje vlerësohen nga një ekip multidisiplinar, ku profesionistët punojnë së bashku për të diskutuar rastin, në përputhje me moshën dhe nevojat e tyre respektive, me qëllim hartimin e planit përkatës të ndihmës.

3.12. Për çdo fëmijë/përfitues caktohet një punonjës social, i cili menaxhon rastin. Menaxheri i rastit udhëheq procesin e vlerësimit të nevojave të përfitueses, hartimin e planit të ndihmës dhe zbatimin e tij. Menaxheri i rastit ndjek me rigorozitet gjithe komunikimin dhe së bashku me punonjësin për mbrojtjen e fëmijëve në bashki koordinon qëndrimin e fëmijës në strehëz dhe hapat që do të ndërmerren në kohë afatshkurtër dhe afatmesëm. Menaxheri dhe /ose psikologu mban komunikim të rregullt me fëmijën për të qartësuar hap pas hapi gjithë procesin që është duke ndodhur, me qëllim të sigurojë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e fëmijës në vendimmarjen për të ardhmen e tij. Ai/Ajo drejton organizimin e referimeve dhe lehtëson kalimin e fëmijës nga shërbimi emergjencës në një shërbim tjetër alternativ më afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

3.13. Vlerësimi i nevojave përfshin dimensionet e:

-Zhvillimit të fëmijës ku përfshihen vlerësimin e nevojave shëndetësore (traumatike, abuzimet), arsimore, zhvillimi emocional/sjelljes, marrëdhëniet shoqërore dhe familjare, aftësitë e vtpërkuqdesit, historiku i abuzimit, situata ligjore;

-Aftësitë prindërore, ku përfshihen vlerësimi i nevojave mbi kujdesin bazë të ofruar nga kujdestarët ligjorë, garantimi i sigurisë, ngrëhtësia emocionale, stabiliteti, situata ligjore;

-Faktorët mjedisorë dhe të familjes ku përfshihen vlerësimi i historikut dhe funksionimit të familjes bazë, familjes së zgjeruar, strehimi, punësimi, të ardhurat, integrimi social dhe burimet e komunitetit;

-Vlerësimi i alternativave të tjera të mundshme dhe të qëndrueshme për akomodimin afatgjatë të fëmijës duke konsideruar zhvillimin në fushën e arsimit, profesionale, të punësimit, të sigurisë, të strehimit afatgjatë, të lidhjeve me familjen etj. (Shih anekset e vlerësimit - format e vlerësimit sipas VKM nr.578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes");

3.14. Vlerësimi i nevojave individuale për fëmijën/përfituesin duhet të përfundojë brenda 72 orëve nga momenti i hyrjes së tij në strehëz, ku primar është vlerësimi shëndetësor, psikologjik, social dhe ligjor;

3.15. Pasi kryhet vlerësimi i nevojave, ekipi multidisiplinar që përbëhet nga punonjësi social dhe psikologu i qendrës, nga mjeku pediatër i qendrës shëndetësore më të afërt, apo specialist shëndetësie i kontraktuar nga strehëza, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në bashki, punonjës policie dhe çdo aktor tjetër përfshirë në trajtimin dhe masën e mbrojtjes së fëmijës, vetë fëmija/përfituesikur është e mundur, mblidhet si një grup për të diskutuar rastin dhe për të hartuar planin individual të përkujdesit;

Planifikimi individual indërhyrjes

3.16. Plani i ndihmës hartohet pas vlerësimit të nevojave dhe përfshin masat të ndërhyrjes afatshkurtër dhe afatmesëm. Ky plan ka si qëllim të plotësojë çdo nevojë imediate të fëmijës si edhe të marrë masa për realizimin e aktiviteteve për sistemimin e fëmijës në një shërbim të kujdesit alternativ të qëndrueshëm, si p.sh. familja biologjike kur është e mundur, familje kujdestare me /pa lidhje gjaku, kujdes alternativ tjetër.

3.17. Plani i ndihmës hartohet brenda 7 ditësh nga dita e akomodimi të fëmijës/përfituesit në strehëz ose plotësohet bazuar në veprimet e realizuara në rast se fëmija/përfituesi largohet nga SHSES përpara këij afati

3.18. Fëmija/Përfituesi përfshihet në procesin e hartimit të planit individual të ndërhyrjes në përputhje me grupmoshën, kapacitetin dhe aftësitë individuale të tij/ saj.

3.19. I gjithë grupeve multidisiplinare mban përgjegjësinë e realizimit të planit që nga momenti i hyrjes së fëmijës në strehëz deri në vendosjen e tij në shërbimin tjetër të përshtatshëm. Në planin e ndërhyrjes përcaktohen qartë, kush do të bëjë çfarë dhe kur, cila është kostoja për çdo shërbim dhe kush do të bëjë të mundur realzimin e tij. Menaxheri i rastit bashkëpunon me ekipin multidisiplinare për të siguruar gjithë informacionin e nevojshëm. Ai përdor rezultatet e vlerësimit, analizës së informacionit, zhvillimit të proceseve gjyqësore, si dhe formularët e vlerësimit të nevojave për të hartuar së bashku me aktorët dhe me përfituesen (kur është e mundur) një plan përkujdesi tërësor. Plani i ndihmës është formatuar në përputhje me formularët e vlerësimit të nevojave, në mënyrë që t'i korrespondojë me lehtësi procesit të vlerësimit të nevojave (format e vlerësimit sipas VKM nr.578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbytjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”).

3.20. Të gjithë anëtarët e grupit multidisplinar duhet të nënshkruajnë planin për të treguar që secila palë është e angazhuar për zbatimin e tij.

3.21. Plani i ndihmës përditësohet e përshtatet me ndryshimet e nevojave dhe rrethanave të fëmijës/përfituesit gjatë kohës së qëndrimit në shërbimin e emergjencës. Në planin e ndërhyrjes parashikohet edhe momenti i largimit për në shërbimin tjetër të fëmijës, kush do ta shoqërojëdhe transportojë si edhe parashikohet monitorimi në bashkëpunim me strukturat e MF i fëmijës në tre muajt e ardhshëm. Gjatë gjithë procesit, fëmija vihet në dijeni dhe bëhet pjesë e çdo veprimi që merret për të.

3.22 Për çdo fëmijë që vendoset në shërbimin e emergjencës, punonjësit të mbrojtjes së fëmijës në bashki i jepet një kopje e planit tëndërhyrjes individual. Nëse fëmija transferohet në një strehëz tjetër përkujdesjes shoqërore, një kopje e planit të ndihmës duhet t'i dërgohet ofruesit të ri të shërbimeve, në mënyrë që ndihma e filluar të vazhdojë të ofrohet, si dhe ofruesi i ri të kuptojë se cilat shërbimet i janë ofruar fëmijës/përfituesit deri në atë moment.

Përfundimi i shërbimit të emergjencës

3.23 Shërbimi i emergjencës duhet të sigurojë që personat e mëposhtëm, sipas rastit, të përfshihen në planifikimin e daljes së një fëmije nga shërbimi:

- a. Fëmija
- b. Kujdestari ligjor i fëmijës ose prindërit, nëse shërbimi i emergjencës e di identitetin e kujdestarit ose të prindërve dhe si t'i kontaktojë ata
- c. Stafi i shërbimit
- d. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës

3.24 Shërbimi i emergjencës duhet të dokumentojë në dosjen e fëmijës datën dhe rrëthanat e daljes së fëmijës. Ky shërbim duhet të shënojë emrin, adresën dhe marrëdhënien e personit të cilit i dërgohet fëmija, masën administrative apo gjyqësore që është marrë për transferimin e fëmijës

3.25 Shërbimi emergjent nuk duhet të nxjerrë një fëmijë me përjashtim të rasteve kur ka një autorizim me shkrim nga një institucion i autorizuar për mbrojtjen e fëmijës, prindi ose kujdestari i ligjor (gjithmonë kur ky i fundit nuk është abuzues), për këdo tjetër përvëç:

- a. prindërit;
- b. kujdestari ligjor;
- c. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimet, personeli;
- d. stafi i agjencisë së mbrojtjes së fëmijës.

3.26 Nëse shërbimi i emergjencës nuk është në gjendje të planifikojë daljen e fëmijës me personat sipas standardit, duhet të dokumentojë rrëthanat në dosjen e fëmijës nëse:

- a. një dalje emergjente është e nevojshme;
- b. një fëmijë largohet pa pëlqimin e institucionit;
- c. një fëmijë plotëson kushtet për të marrë pëlqimin nga shërbimi emergjent dhe vendos që të mos përfshijë kujdestarin procedural ose prindërit në planifikimin për daljen e fëmijës .

3.27 Dokumentacioni i largimit të fëmijës nga shërbimi i emergjencës

- procesverbal i daljes nga strehëza i nënshkruar nga palët

- procesverbal i shoqërimit dhe dorëzimit për në shërbimin/familjen.
- kopje të dokumnetacionit si plan përkujdesi, ekzaminime mjekësore,etj.

4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesit

4.1. Shërbimet e emergjencës hartojnë dokumentacion të qartë të të drejtave dhe përgjegjësive të fëmijëve/përfituesve që hyjnë në strehëz. Këto të drejta dhe përgjegjësi duhet të jenë të shkruara në gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar çdo grup moshë fëmijësh, pa ose me aftësi të kufizuara, të afishuara në vende lehtësish të dukshme dhe të arritshme dhe stafi duhet të kujdeset që të zëvendësohen sa herë dëmtohen apo është e nevojshme. Të drejtat duhet të përfshijnë minimalisht të drejtën për t'u trajtuar me respekt dhe dinjitet, për pjesëmarrje, vendimmarrje, për t'u larguar në çdo moment nga strehëza e vlefshme vetëm për personat madhorë, për t'u ankuar pa pasur frikën e pasojave negative dhe për akomodim të sigurtë, ushqim të mjaftueshëm dhe të shëndetshëm gjatë qëndrimit në strehëz.

4.2. Shërbimet e emergjencës hartojnë rregullat e qendrës. Këto rregulla duhet të jenë të shkruara në një gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Këtu përfshihen të gjitha rregullat që ka strehëza. Ofruesit e shërbimeve duhet të rivlerësojnë rregullisht rregulloret e tyre për t'u siguruar që ato nuk kanë ndonjë rregull të pavlefshëm ose të panevojshëm, të cilët vendosin kufizime mbi jetën e fëmijëve/ përfituesve.

4.3. Përbajtja e këtyre dokumenteve duhet të përfshihet në dokumentin e pranimit e cila duhet nënshkruar nga fëmijët mbi 16 vjeç dhe përfituesit madhorë, pasi ti jetë shpjeguar nga stafi, përbajtja dhe të sigurohet gjatë intervistës që është e kuptuar qartë qëllimi dhe arsyja e hartimit të kësaj rregulloreje.

4.4. Stafi i shërbimit të emergjencës sigurohet të përfshijë fëmijët/përfituesit në vendimmarrjen që lidhet funksionimin e qendrës dhe në me jetën e përditshme, duke i nxitur të shprehin mendime për shërbimet dhe rregullat e vendosura, për orarin e ngrënies, të aktiviteteve, orarin e pastrimit, etj.

4.5. Fëmijët inkurajohen dhe marrin pjesë në planifikimin e menusë, përgatitjen e vakteve, shtrimin e tavolinës. Sugjerimet dhe preferencat e saj duhet të plotësohen për sa kohë ato janë brenda buxhetit dhe sigurojnë një dietë të balancuar dhe ushqyese.

4.6. Pjesëmarrja në shërbimin e emergjencës është i kushtëzuar nga masa e mbrojtjes dhe situate e emergjencës. Largimi nga ky shërbim është vullnetar vetëm për personat madhorë, pavarësisht se mund të kenë fëmijë me vete. Shërbimi i emergjencës ka procedura për të siguruar që përfituesi ndërmerr një veprim me vullnetin e tij të lirë. Në rastet kur një përfitues i rritur dëshiron të largohet, përfituesja, menaxheri i rastit të saj dhe punonjësi epror në turn, plotësojnë dhe nënshkruajnë formularin e largimit, pasi kanë sqaruar të gjithë situatën që ka

sjellë në këtë vendimmarrje. Në rastin e të miturve, largimi i tyre ndodh vetëm pasi është marrë një vendim administrative ose vendim gjykate.

4.7. Nëse një i mitur/përfitues largohet pa njoftuar nga strehëza, duhet të informohet menjëherë policia, në mënyrë që të fillojë menjëherë kërkimi i tij. Një kërkim i tillë bëhet për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e të miturit/përfituesit. Pas gjetjes së fëmijës, stafi i qendrës diskuton me të për arsyet e largimit, mbledh menjëherë ekipin multidisiplinar dhe trajton mundësinë për të qëndruar në strehëz apo gjetjen e alternativave të tjera më të përshtatshme.

4.8. Shërbimi i emergjencës siguron një procedurë legjitime dhe funksionale për ankimet.

Fëmija mund të ankohet rreth çdo aspekti të jetesës së tij/saj në strehëz, si dhe për shërbimet që ka marrë ose jo, për mënyrën si është trajtuar. Ofruesi i shërbimeve duhet t'i konsiderojë këto ankesa si një mundësi për të përmirësuar performancën e tij. Asnjë pasojë negative nuk mund të ketë përfituesen për shkak të paraqitjes së një ankesë.

4.9. Shërbimi i emergjencës duhet të ketë procedura të qarta me shkrim për trajtimin e ankesave. Këto procedura duhet të shpjegojnë mënyrat e ndryshme të ankimit që mund të përdoren nga fëmija, që mund të jenë verbal, me shkrim.

4.10. Shërbimi i emergjencës do të mbajë dhe një regjistër ankesash. Në këtë regjistër duhet të përfshihet personi përgjegjës për t'iu përgjigjur ankesës, rezultatet nga hetimi i ankesës, si është trajtuar ankesa dhe dokumentacion të shkruar mbi përgjigjen që i është dhënë personit që ka bërë ankesën, nëse ankesa nuk ishte anonime.

4.11. Çdo anëtar stafi i Shërbimit të emergjencës që merr një ankesë me gojë nga një përfituese, duhet ta regjistrojë këtë ankesë në regjistrin e ankesave, së bashku me datën e ankesës dhe të dokumentojë mënyrën se si është trajtuar ankesa.

4.12. Të gjitha ankesat duhet të marrin përgjigje me shkrim dhe një kopje e përgjigjes me shkrim të përfshihet në regjistrin e ankesave. Inspektimi i ankesave vërteton se ato janë trajtuar me seriozitet dhe në kohën e duhur.

5. Të dhënat personale të fëmijës/përfituesit dhe mënyrat e menaxhimit të tyre

5.1. Për secilin fëmijë dhe përfitues që qëndron në strehëz, Shërbimi i emergjencës duhet të hapë dhe të mbajë një dosje individuale. Kjo dosje individuale duhet të përbajë të paktën dokumentet e mëposhtme:

a) Procesverbalin e hyrjes në strehëz, i cili është nënshkruar nga agjencia referuese, stafi i qendrës dhe kur është e mundur nga fëmija/përfituesi.

Aneksi 1 Formulari për identifikimin proaktiv

Aneksi 2 Formulari i raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje

Aneksi 3 Formulari i vlerësimit fillestare

Aneksi 4 Formularin për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime në rast se realizohen apo mund të vihet në dispzicion nga PMF

Aneksi 5 Formulari i intervistimit

Aneksi 6 Formulari i vlerësimit sipas dimensioneve dhe analiza e rrezikut

Aneksi 7 Formulari i planit individual të mbrojtjes

Aneksi 8 Formulari i shqyrtimit të progresit/planit individual për mbrojtjen e fëmijës

Aneksi 9 Mbyllja e rastit

Aneksi 10 Procesverbali për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëherëshme

Aneksi 11 Formular miratimi për ndarjen e informacionit

Aneksi 12 Fleta e ditarit

Proçes verbal për largimin nga strehëza

Proçes verbal për shoqërimin dhe dorëzimin e fëmijës pranë familjes apo shërbimit tjetër.

Foto dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm dhe i disponueshëm

Të gjithë formularët e cituar më sipër duhet të plotësohen për çdo individ që merr shërbime në strehëz edhe nëse është rast i përsëritur.

b) Shënime nga intervistat/diskutimet. Ofruesi i shërbimeve duhet të mbajë shënimet me shkrim mbi të gjitha takimet dhe diskutimet me fëmijën/përfituesin, familjen, ofruesit e tjerë të shërbimeve apo autoritetet, që lidhen me rastin dhe përkujdesjen ndaj tij duke përfshirë çdo shënim të nevojshëm në dosje.

c) Nëse përfituesi nuk është vizituar nga një mjek, dokumentet e pranimit të përfshijnë një hartë trupore dhe nëse është nevoja, fotografi të lëndimeve, të cilat të mund të përdoren më vonë. Shpesh, një i mitur për shkak të rr Ethanave, nuk vendos t'i drejtohet menjëherë sistemit të drejtësisë penale, por më vonë mund të ndërrojë mendje. Pra, është mirë të ruhen dhe dokumentohen provat për t'ia rritur mundësitë përfituesit. Në çdo rast ekzaminimi i të miturit, duhet të jetë i pranishëm edhe psikologu. Asnjëherë nuk duhet vepruar për të bërë foto pa dëshirën e të miturit. Psikologu duhet të tentojë bindjen e tij.

5.2. Të dhënat personale përfshijnë gjithçka që është në dosjen personale që përshkruhet më lart, si dhe çdo dokument tjetër që mund të zbulojë identitetin ose vendndodhjen e fëmijës/përfituesit, p.sh.

qytetin e origjinës (nëse ata vijnë nga një qytet i vogël), informacion shëndetësor, informacion rreth familjes së saj/tij ose situatës familjare, ose ndonjë detaj tjetër personal apo privat.

5.3. Dokumentacioni i fëmijës/përfitues/it duhet të jenë konfidenciale. Dokumentacioni mbahet në një vend të sigurtë. Dokumentacioni aksesohet vetëm nga punonjësi social, menaxheri i rastit, drejtuesi i qendrës dhe nga fëmija/përfituesi. Administrimi i dokumentacionit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

a - SHSES duhet të diskutojnë dhe të vendosin paraprakisht se deri ku duhet të shkojnë për të mbrojtur fshehtësinë e të dhënavë dhe për të mos i dorëzuar dosjet edhe kur këtë ua kërkojnë organet zyrtare. Organet e forcave të ligjit nuk kanë lirishikimi të informacionit pa urdhër të gjykatës, për të cilin qendrës i jepet kohë e mjaftueshme për t'u përgjigjur.

b - Nëse gjatë intervistimit dhe vlerësimit, sigurohet informacion që mund ta vendosë në rrezik përfituesin ose një person tjetër, në përputhje me kodin etik të profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve sociale, ofruesi i shërbimeve është i detyruar të informojë PMF dhe strukturat përkatëse në Bashki. Ky i fundit duhet të informojë autoritetet e forcave të ligjit.

Këtu përfshihen edhe rastet e identikuara të abuzimit ndaj të miturit, të cilat nuk kanë qenë objekt i aplikimit të masës së emergjencës.

5.4. Fëmijët/përfituesit kanë akses në dosjet e tyre dhe informohen se kanë akses në dosjen e tyre, nëse ata dëshirojnë.

5.5. Ofruesi i shërbimeve duhet të mbrojë të gjitha të dhënat personale të fëmijëve. Ofruesi i shërbimeve është i detyruar të sigurojë që dosjet e printuara dhe dosjet elektronike me të dhëna të ruhen të sigurtë. Për dosjet e printuara, kjo duhet të bëhet nëpërmjet ruajtjes së dosjeve në rafte të myllura me çelës në një dhomë që është e kyçur. Për dosjet elektronike, ato duhet të ruhen me fjalëkalim.

5.6. Kur fëmija/përfituesi transferohen në një strehëz tjetër, bëhet dhe transferimi i dosjeve). Shërbimi referues mban kopjet origjinale në dosjet e tij, ndërsa fotokopjet i dërgon te ofruesi i ri i shërbimeve, me qëllim që të vazhdohet ndihma në bazë të shërbimeve që i janë dhënë rastitderi në atë kohë dhe jo të fillojë gjithçka nga e para.

6. Menaxhimi dhe administrimi i brendshëm i SHSES

6.1. Shërbimi i emergjencës ka një strukturë të nevojshme të personelit në përputhje me nevojat e fëmijëve. Organograma e ofruesit të shërbimeve paraqet në mënyrë grafike të gjitha pozicionet brenda organizatës ose agjencisë që lidhen me funksionimin e shërbimit të emergjencës, si edhe marrëdhëniet e varësisë dhe të mbikëqyrjes së saj (organograma e miratuar).

6.2. Stafi duhet të rekrutohet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe transparent si dhe në përputhje me Ligjin 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

6.3. Ofruesi i shërbimeve duhet të mbajë dosje për të gjithë punonjësit që janë marrë në punë. Secila dosje individuale e punonjësit përfshin: CV-në e punonjësit, diplomë, dëshmi penaliteti, certifikatat profesionale, rekomandime, përshkrimin e detyrave, kontratën e punës, vlerësimet e performancës, certifikata mjekësore etj.

a- Ofruesi i shërbimeve vendosë të punësojë ose kontraktojë punonjës në përputhje me nevojat specifike të fëmijëve, për shkak të natyrës së shërbimeve dhe dinamikës së formave të abuzimit dhe dhunës së ushtruar.

b- Është shumë e rëndësishme përzgjedhja e kujdeshme e trajnimit, për të ruajtur filozofinë e shërbimit, që është siguria, mbrojtja e femijëve dhe fuqizimi i fëmijëve/ përfituesve dhe familjeve të tyre.

6.4. Ofruesi i shërbimeve përgatit dhe shpérndan materiale të shkruara (broshura, fletëpalosje etj.) rreth organizatës/agjencisë dhe shërbimeve të ofruara në mënyrë që përfitueset të jenë të informuara mirë rreth mundësive që kanë për t'u ndihmuar.

6.5. Për secilin pozicion, ofruesi i shërbimeve duhet të hartojë përshkrimin e vendeve të punës, ku përcaktohen përgjegjësitë, detyrat, arsimimi, kualifikimi. Pozicionet dhe kualifikimet duhet të korrespondojnë me shërbimet e ofruara.

6.6. Stafi duhet të nënshkruajë një kontratë pune që është në përputhje me Kodin e Punës. Kontrata e punës duhet të përfshijë minimalisht: përshkrimin e detyrave, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit, marrëdhëniet e varësisë, referencat te çdo rregullore e brendshme, siç janë kodet e etikës, marrëveshjet e konfidencialitetit etj.

6.7. Detyrimet e stafit ndaj fëmijëve duhet të afishohen në ambientet e qendrës që të gjithë përfituesit të mund t'i shohin.

6.8. Çdo ofrues shërbimesh duhet të ketë një plan trajnimi për punonjësit e rinj. Plani i trajnimit duhet të përfshijë të gjitha fushat kryesore të nevojshme të trajnimit, objektivat për secilin sesion dhe mënyrën se si do të ofrohet trajnimi. Punonjësi/ja i/e ri/re merr një trajnim të brendshëm për të kuptuar më mirë misionin e ofruesit të shërbimeve dhe rolin e tij në ndihmën ndaj përfitueseve

6.9. Punonjësit marrin trajnim të vazhdueshëm profesional gjatë kohës që janë të punësuar në strehëz. Fuqizimi i stafit është shumë i dobishëm në rritjen e motivimit të tij dhe reduktimin e konsumimit profesional, duke i lejuar ata të ndihmojnë përfitueset dhe të përmbushin rolin e tyre.

6.10. Ofruesit e shërbimeve organizojnë takime të rregullta të menaxhimit të rasteve. Në këto takime mblidhet i gjithë stafi, ekipi multidisiplinar dhe drejtuesit për të shqyrtuar së bashku

situatat e fëmijëve. Këto takime duhet të organizohen rregullisht: minimalisht çdo javë, çdo dy javë ose çdo muaj.

6.11. Shërbimet e këshillimit duhet të ofrohen nga profesionistë të trajnuar, siç është një punonjës social ose psikologu. Prandaj, minimalisht, çdo ofrues shërbimesh duhet të ketë në stafin e tij një profesionist të tillë të pranishëm ose të kontraktuarë supervisor të jashtëm.

6.12. Puna e personelit vlerësohet një herë në vit. Raporti i vlerësimit nënshkruhet si nga personi të cilit i bëhet vlerësimi dhe nga supervizori që kryen vlerësimin.

6.13. Ofruesi i shërbimeve duhet të vendosë kufizime se kush mund të vizitojë qendrën, sa njerëz mund ta vizitojnë njëherazi, çfarë mund t'u lejohet vizitorëve që të bëjnë dhe sa shpesht do të lejohen vizitorët. Këto rregulla për vizitat duhet të jenë të shkruara dhe të mirëpërcaktuara.

6.14. Të gjithë vizitorët nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti përpara ose apo të mbërrijnë në strehëz.

7. Siguria e përfituesve të shërbimeve dhe e stafit

7.1. Ofruesi i shërbimeve duhet të ndërmarrë një vlerësim të plotë dhe profesional të sigurisë për godinën ku do të strehohen përfitueset. Vlerësimi duhet të deklarojë qartë të gjitha masat e sigurisë që duhet të vendosen. Raporti final nga vlerësimi i sigurisë duhet të ruhet në dosjet e ofruesit të shërbimeve. Vlerësimi i sigurisë së godinës duhet të përditësohet rregullisht. Niveli i sigurisë duhet të rivlerësohet minimalisht çdo vit.

7.2. Në përputhje me kërkesën për siguri të përfitueseve dhe të stafit, ofruesi i shërbimit merr masa për garantimin e sigurisë së institucionit nga policia e shtetit ose policia private.

7.3. Për çdo fëmijë/përfitues nëstrehëz kryhet një vlerësim individual i sigurisë. Ky vlerësim merr në konsideratë situatën individuale të fëmijës/përfituesit, marrëdhëniet me familjen, marrëdhëniet me dhunuesin, marrëdhëniet e familjes me dhunuesin e, etj. Ofruesit e shërbimeve duhet të marrin në konsideratë këndvështrimin personal të fëmijës/përfituesit për këto çështje, si dhe mendimin e autoritetetive ligjore ose agjencive referuese (mendim i shprehur në vlerësimet apo vendimet përkatëse)

7.4. Çdo dosje e fëmijës duhet të ketë një kopje të përcaktimit të nivelit të rezikut dhe dokumentacion mbi masat e marra për mbrojtje kundër kërcënimeve të identikuara. Ofruesi i shërbimeve duhet të vendosë nëse situata e sigurisë së fëmijës e lejon atë të marrë pjesë në programin e tyre dhe të qëndrojnë në qendrën e tyre, bazuar në nivelin e sigurisë që mund të ofrojë strehëza.

7.5. Vlerësimet e sigurisë individuale rivlerësohen periodikisht. Ndryshimet në çështjet ligjore të fëmijës, situata familjare, ose dhe lëvizjet e pritura (për shembull, për të shkuar në gjykatë ose për një vizitë në familje), përbëjnë kërcënim të mundshëm dhe duhet të jetë arsyё për një vlerësim të ri.

7.6. Ofruesi i shërbimeve ka vendosur rregulla dhe procedura sigurie për qendrën.

a) Procedurat e evakuimit të menjëhershëm në rast zjarri ose arsyё tjetër për evakuim të godinës. Këto duhet të jenë me shkrim dhe të afishuara në strehëz. Ofruesit e shërbimeve duhet të kenë një plan se ku do të dërgohen përfituesit në rast të evakuimit të qendrës. Për këtë qëllim, këshillohet përdorimi i rrjetit të shërbimeve të tjera.

b) Duhet që të afishohen informacionet e kontaktit në strehëz për policinë, urgjencën, spitalin, zjarrfikësit dhe kontakte të tjera të emergjencës.

c) Gjithashtu, duhet të ketë rregullore dhe procedura sigurie të hartuara posaçërisht për stafin. Këto duhet të përfshijnë trajnime të rregullta dhe informacione të sigurisë, procedura për takime, etj.

d) Ka rregulla të sigurisë, veçanërisht për fëmijët/përfituesit. Rregullat e sigurisë përfshijnë masa të sigurisë personale, shërbime shoqërimtransport për lëvizjet e rrezikshme, rregulla për dhënier e informacionit rreth vendndodhjes së qendrës, stafit ose përfituesëve të tjerë, përdorimi i celularëve etj.

e) Duhet të ketë procedura sigurie për vizitorët në godinën e qendrës. Këto përfshijnë masa përmbrojtjen e vendndodhjes së qendrës, ruajtjen e qendrës nga dhunuesit, respektimin e privatësisë dhe konfidencialitetit të përfitueseve, dhe mbrojtjen e identitetit të stafit dhe përfitueseve.

7.7. Ofruesit e shërbimeve trajnojnë stafin e tyre rreth sigurisë. Kjo duhet të përfshihet në trajnimin fillesttar për të gjithë individët e marrë në punë rishtas. Ky trajnim duhet t'i jepet të gjithë stafit, jo vetëm stafit profesional, por dhe kuzhinierëve, pastruesve, shoferëve dhe të tjerëve, meqenëse secili ka një rol për të luajtur për sa i përket sigurisë. Trajnim i sigurisë mund të përfshijë:

- a) një rishikim të procedurave dhe rregullave për stafin, fëmijëtpërfituesit dhe vizitorët;
- b) njojja e sistemeve të sigurisë së qendrës;
- c) teknika bazë të vetëmbrojtjes;
- d) dhënier e ndihmës së parë.

8. Vlerësimi i shërbimeve të ofruara nëpërmjet inspektimit dhe monitorimit

8.1. Çdo ofrues shërbimesh kanë në fokus kryesor dhënien e shërbimeve sa më cilësore dhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijëve. Për këtë arsyen janë objekt i inspektimeve nga struktura kompetente. Theksi në këto inspektime është i vendosur në parandalimin e rrezikut për fëmijët që janë nën kujdes. Të gjitha procedurat e ndjekura duhet të janë të përcaktuara në një plan monitorimi të kordinuar dhe të bazuar në standarte.

8.2 Secili ofrues i shërbimeve ka strukturën e vet të cilës i është ngarkuar detyra e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, duke mbajtur në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimeve që duhen përmbushur

8.3 Çdo ofrues shërbimesh është objekt inspektimi nga Inspektorati i shërbimeve Shoqërore, nga Drejtoria e Shëndetit Publik dhe nga strukturat përkatëse në Bashki, 1-2 herë në vit.

8.4. Gjatë çdo inspektimi, nëse stafi i licencimit konstaton se objekti nuk i plotëson standardet minimale në fusha të caktuara, këto fusha diskutohen me punonjësit profesionist, kujdestarët apo supervizorë. Punonjësit e strehëzës dhe kujdestarët mund të diskutojnë mosmarrëveshjet dhe shqetësimet me stafin e licencimit (inspektorët) duke kërkuar në të nejtën kohë edhe asistencë teknike, konsultime për problematikën e hasur. Nëse shqetësimet nuk zgjidhen, ofruesi i shërbimit (strehëzës së emergjencës) mund të kërkojë një shqyrtim administrativ

8.5. Pjesë e punës së inspektoriatit është të ofrojë konsultime për aplikantët potencialë dhe përfituesit e lejeve për përmbushjen dhe qëndrueshmërinë e standardeve-asistencë teknike

8.6. Hetimi i Ankesave- Kur një ankesë sinjalizon për keqpërdorim ose neglizhencë, mangësi në zbatimin e standardeve ose shkelje të ligjit, inspektorati duhet të hetojë, të informoj mbi veprimet e hetimit dhe të japë një raport me shkrim mbi rezultatet e atij hetimi brenda afateve kohore të përcaktuara.

8.7. Strehimi emergjent duhet të raportojë në Institucionet e Licencimit brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes së fatkeqësive ose situatave emergjente, siç janë zjarret ose moti i ashpër, që kërkojnë mbylljen e shërbimit të emergjencës.

8.8. Administratori i shërbimit të emergjencës duhet të paraqesë raporte për Institucionin e Liçencimit për çdo:

- a. ndryshim në administrim;
- b. (kapaciteti, mosha, gjinia, vendndodhja ose emri).

8.9 Dhënia e mendimit të fëmijës/përfituesit para largimit nga strehëza, mbi shërbimet e marra apo sygjerime për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, janë ndihmues të rëndësishëm në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të punës së stafit.

9. Buxhetimi i sigurtë i shërbimeve të ofruara në shërbimin e emergjencës

9.1.Çdo shërbim që duhet të ofrohet në strehëz, duhet të jetë i siguruar me një buxhetim të qëndrueshmët paktën për një vit kalendarik, përpara se të fillojë të funksionojë si strehëz emergjencë.

9.2.Bashkia duhet të sigurojë vazhdimësi të shërbimit nëpërmjet sigurimit të fondeve si nga buxheti i saj , ashtu edhe nëpërmjet bashkëpunimit me organizata jo fitimprurëse të cilat kanë në focus mbrojtjen e fëmijëve.

9.3. Ofruesit e shërbimeve bëjnë çdo përpjekje për të gjetur partneritet me strukturat dhe shërbimet e tjera, duke siguruar ndjekjen e ecurisë dhe plotësimin e nevojave të përfitueseve dhe rikthimin e tyre në jetën normale.

9.4. Çdo ofrues shërbimesh zhvillon marrëdhënie formale bashkëpunimi me institucione dhe organizata, me qëllim ofrimin e një game më të gjërë të mundësive të ndihmës për përfitueset.

9.5. Marrëdhëni mund të formalizohen nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi të nënshkruar, por ato mund të janë dhe informale. Dokumentacioni mbi këto marrëveshje duhet të ruhet dhe mund të përfshijë kopje të marrëveshjeve formale, shënimë nga takimet, planet e veprimit dhe dokumentacioni i referimeve.

Aneks 1: Deklarata e qëllimit

Protokolli i veprimeve për ofrimin e shërbimeve të SHSES

HYRJE

MISIONI

QËLLIMI

MODEL I SHËRBIMIT

OBJEKTIVAT

PARIMET

PËRSHKRM I SHËRBIMEVE

STRUKTURA

PËRSHKRM I PUNËS

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

HYRJE

Shërbimi i Strehimit Emergjent të Sigurtë është një shërbim që ofrohet për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje. SHSES është një shërbim i ngritur ose i kontratuar nga çdo njësi vendore në nivel bashkia apo qarku dhe ofron strehim të sigurtë, akomodim dhe shërbime mbrojtëse për fëmijët nga mosha 0-18 vjeç dhe prindërit me fëmijë, të cilët në rrethana të caktuara nuk janë të aftë të kujdesen për veten. Aktiviteti i këtij Shërbimi përputhet me kërkesat e legjislacionit për shërbimet sociale dhe me standartet e parashikuara për këtë tipologji.

MISIONI

Sigurimi i mbrojtjes dhe mirëqënies për të gjithë fëmijët në rrezik.

QËLLIMI

Synimi kryesor i Shërbimit të Strehimit Emergjent së Sigurtë për fëmijë është që të sigurojë ofrimin efektiv dhe efikas të shërbimeve mbrojtëse të menjëherershme për fëmijët e në rrezik (abuzuar, keqtrajtuar, trafikuar, në kontakt me ligjin, të pashoqëruar, etj.) dhe në nevojë, gjatë dhe pas orarit zyrtar, 24/7, duke

- mbrojtur fëmijën nga dëmtimi;
- vendosur fëmijën në një ambjent të sigurtë;
- mbrojtur të drejtate fëmijës;
- promovuar zhvillimin e fëmijës.

MODEL I SHËRBIMIT

SHSES për fëmijën është pjesë e sistemit të integruar dhe të mirë koordinuar të mbrotjes së fëmijëve në nivel vendor, rajonal dhe qëndror dhe është i parashikuar në Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqërtor në Republikën e Shqipërisë”, neni 8,18,19, 24, neni 15 dhe Ligjin 18/2017 “ Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 56,57, VKM nr 518, dt.04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit rezidencial, kriteret, procedurat përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKM nr.578 dt. 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e tënmenaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve përzbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

LLOJET E SHËRBIMEVE

1. Shërbim i gatshëm (on call)

2. Shërbim rezidencial

- Akomodim, strehim të sigurtë
- Ushqim
- Veshmbathje
- Higjenë
- Kujdes shëndetësor

3. Transport

- Referim/raportim
- Mbështetje psikologjik
- Mbështetje psikosociale

4. Mbështetje edukative

Për çdo fëmijë ka një plan ndërhyje të hartuar bashkërisht me fëmijën/përfituesin mbi bazën e nevojave individuale dhe me objektiva të qarta, i cili synon të sigurojë mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet bashkërendimit të punës mes të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes së fëmijës, në interesin më të lartë të tij, nëpërmjet gjithëpërfshirjes në një numër veprimtarish të koordinuara, aktivitetesh, programe profesionale në një mjedis stimulues, pozitiv dhe të sigurtë.

OBJEKTIVAT

- Të paraqesë setin e standardeve të SHSES për shërbimet mbrojtëse përfituesin së fëmijët në rrezik të menjëhershëm;
- Të ofrojë një kornizë të veprimeve institucionale brenda sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve përfituesin së fëmijët në rrezik të menjëhershëm;

- Të ofrojë një kornizë të procedurave në përputhje me praktikat më të mira të punës me fëmijët me nevojë për shërbime të emergjencës në mbrojtje të tyre për të siguar mbrojtjen dhe garantuar respektimin e të drejtave të tyre;
- Të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimeve dhe strukturave përgjegjëse sipas legjisacionit në fuqi për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve;
- Të sigurojë ndërhyrje/përgjigje emergjente, gjatë/pas orarit zyrtar, për fëmijët në rrezik dëmtimi nga të gjitha format e abuzimit, neglizhimit, ose në rrezik shfrytëzimi ose paraburgimi²⁰;
- Të përcaktojë indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit të veprimeve për të siguar respektimin e ndërhyrjes sipas legjisacionit në fuqi.

PARIMET

- ✓ Universaliteti, fëmija është bartës i të drejtave që janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progressive,
- ✓ Interesi mëi lartëi fëmijës është konsiderata parësore nëçdo veprim që ka të bëjë me fëmijën,
- ✓ Drejtësia sociale,
- ✓ Subsidiariteti,
- ✓ Mbështetja shoqërore dhe ofrim i shërbimit të specializuar për çdo fëmijë,
- ✓ Deinstitucionalizimi dhe decentralizim të shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijëve,
- ✓ Partneriteti ndërmjet institucioneve dhe ndërhyrje ndërsektoriale,
- ✓ Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës si dhe i të drejtave të njeriut,
- ✓ Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës në përputhje me moshën dheaftësinë e tij për të kupuar,
- ✓ Mosdiskriminimi dhe barazia,
- ✓ Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale,

Garantim i stabilitetit të vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimit të fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor e gjuhësor.

PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE

- SHSES ka staf në dispozicion 24 orë në ditë, në 7 ditë të javës, të cilët janë të gatshëm (on call) dhe në varësi të rasteve. Koha e përfitimit të shërbimeve në SHSES është nga 24 orë deri në 30 ditë.

²⁰ Bazuar në Kodin e drejtësisë për të mitur

- SHSES është në varësi dhe/ose i vendosur pranë SPSHSB. Shërbimi ka numrat e tij të kontaktit, të cilat janë të afishuara në të gjitha sallat operative të policisë dhe urgjencave te tjetra përfshi ALO 116-111, ashtu sikundër është numri i policisë për referime nga çdo qytetar apo profesionist. Referimet vijnë nga shërbimet e sipërpërmënduara nga i gjithë territori në të cilën ushtrojnë aktivitetetin SHSES. Vendndodhja e këtyre shërbimeve mbahet sekret për të siguruar konfidencialitetin dhe mbrojtjen;
- SHSES kanë 3 ekipe me nga tre staf, i përbërë nga 2 profesionistë (1 punonjës social dhe 1 psikolog) dhe një staf mbështetës²¹ me përvojë në mbrojtjen e fëmijëve, secila me një udhëheqës të ekipit, i cili është pritës i referimit qoftë nëpërmjet telefonit ashtu edhe nëpërmjet mjeteve te tjera të komunikimit. Ekipet punojnë në bazë të kalendarit të hartuar paraprakisht nga koordinatori i shërbimit. Ekipi i parë është i gatshëm ndërsa ekipi i dytë është rezervë (plan B). Këto ekipe koordinojnë punën me skuadrat e terrenit, ekipet e komisariateve dhe Njësinë e mbrojtjes së fëmijës/Punonjësin për mbrojtjen e fëmijës për të ndjekur dhe asistuar rastin edhe në institucione të tjera si komisariat, gjykatë, etj.
- Punonjësit e ekipeve të emergjencës mund të janë me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme bazuar në incidencën si edhe në mundësitetë financiare të secilës bashki/qark.
- Të gjitha referimet nga çfarëdo burim shqyrtohen me prioritet. Pritësi i referimit kërkon dhe mbledh sa më shumë informacione që të jetë e mundur;
- Bazuar në informacionin e mbledhur realizohet dhe vendimarrja për ndërhyrje të menjëherëshme. Kur nuk ka baza për për të ndërmarrë veprime të menjëherëshme referimi rregistrohet thjeshtë si referim;
- SHSES do të pranojnë referime nga bashki të tjera kur ka marrëveshje paraprake bashkëpunimi. (kjo vlen për rastet kur shërbime të tillë janë ngritur në nivel qarku);
- Përgjithësisht SHSES presin referime nga linja kombëtare për ndihmë ndaj fëmijëve ALO 116111, profesionistë të shërbimeve, duke përfshirë dhë shërbime të tjera emergjente;

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Struktura e stafit të SHSES është e nevojshme të përbëhet nga të paktën:

Kordinator-1

Punonjës social -3

Psikologë-3

Punonjës shërbimi-3

Mjek/infermier -1

²¹ Punonjës mbështetës mund të jetë një kujdestar, sanitar ose kuzhinier

Edukatorë-2

Shofer-1

Megjithatë është një strukturë që mbetet të përshtatet me mundësitet dhe nevojat e shërbimit ofruesit që mund të jetë pushteti vendor ose një subjekt i kontratuar, duke u bazuar gjithmonë në standartet e SHSES.

PËRSHKIM I PUNËS

Të gjithë punonjësit zbatojnë Kodin e Sjelljes dhe Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës, pjesë integrale e kësaj Rregulloreje. Gjithashtu ata janë të detyruar të respektojnë Kodin e Punës dhe çdo akt nënligjor që rregullon marrëdhëniet e punës në administratën publike.

Detyrat e punonjësit social

- Punonjësi social është në varësi të koordinatorit të shërbimit dhe SPSHS në Bashki,
- Koordinon punën me PMF/NJMF dhe gjithë aktorët e tjerë në pritjen e fëmijës/ përfituesit dhe strehimin e tij në SHSSH,
- Intervistim i fëmijës/përfituesve, identifikim i nevojave të tyre dhe dokumentim i saktë dhe konfidential i informacionit individual,
- Hartimi i planeve të ndërhyrjes duke nxitur dhe theksuar rëndësinë e rolit/angazhimit të individit gjatë të gjithë procesit,
- Vlerësim i detajuar dhe mbështetje e vazhdueshme për fëmijën/përfituesin në lidhje me problematikat, shqetësimet dhe progresin e bërë për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të parashikuara në planin e ndërhyrjes gjatë kohës së qëndrimit,
- Ofrim i këshillimit psiko-social dhe referimet e duhura në varësi të situatës,
- Organizim i mbledhjeve të grupit multidisiplinar dhe ndërmjetësimi me aktorë të tjerë kur të vlerësohet e nevojshme,
- Të përgatisë dhe të të zbatojë planin mujor të punës dhe të raportojë në mënyrë periodike tek titullari për realizimin e tij,
- Të përgatisë raportet e vlerësimeve periodike për securinë, tematikën e zgjidhjeve të rasteve të paraqitur. Për këtë të bashkëpunojë edhe me specialistët e tjerë të qendrës,
- Të njohë dhe të të zbatojë legjislacionin në fuqi për shërbimin social, kujdestarinë, birësimin dhe veprimtarinë e OFJ-ve,
- Të dokumentojë statistika që do të pasqyrojnë veprimtarinë e tij,
- Jep informacion në linjë telefonike për shërbimet e Qendrës,
- Këshillim online në rastet e nevojshme,
- Është pjesë e ekipit të shoqërimit të të miturit.

Detyrat e Psikologut

- Psikologu është në varësi të koordinatorit të shërbimit të SHSES dhe SPSHS në Bashki,

- Bazuar në vlerësimin e punonjësit social, psikologu merr në konsideratë rastin e fëmijës/ përfituesit me qëllim ofrimin e ndihmës ndaj klientit për arritjen efektive të zhvillimit dhe përshtatjes personale,
- Mbledh informacione rreth përfituesit duke përdorur intervista, teknika vëzhgimi dhe metoda të tjera vlerësimi,
- Zhvillon plane terapeutike dhe trajtimi duke u bazuar në interesat, aftësitë dhe nevojat,
- Këshillon individët, grupet apo familjet duke i ndihmuar të kuptojnë problemet, të vendosin objektivat dhe të zbatojnë plane veprimi realiste,
- Analizon të dhëna si: shënimet gjatë intervistës, rezultatet e testeve dhe manualet e referimit në mënyrë që të identifikojë simptomat dhe të diagnostikojë natyrën e problemit të klientit,
- Referon klientët tek specialistët ose institucione të tjera për trajtim jo këshillimor të problemit,
- Konsultohet dhe bashkëpunon me profesionistët e tjerë të grüpuit multidisiplinar, për të diskutuar rreth progresit të terapive, trajtimeve, burimeve këshilluese ose teknikave dhe ndan informacionin professional,
- Të marrë pjesë aktive në mbledhjet e ekipit multidisiplinar,
- Jep informacion në linjë telefonike për shërbimet e Qendrës,
- Këshillim online në rastet e nevojshme,
- Është pjesë e ekipit të shoqërimit të të miturit.

Detyrat e Mjekut/infermierës

- Mjeku/infermieri është në varësi të të kordinatorit të shërbimit të SHSES dhe Drejtorisë së SHS në Bashki, por në rastet kur nuk është e mundur të ketë një mjek në organikë, atëherë këto detyra kryhen nga një mjek i qendrës shëndetësore më të afërt, në bazë të një marrëveshje të dakortësuar,
- Diagnostikon e vlerëson anën shëndetësore të përfituesve për ruajtjen e mirëqënies dhe të interesave shëndetësore të tij. Rekomandon protokollin e trajtimit të tyre, i cili duhet respektuar me rigorozitet nga stafi i turneve,
- Këshillon përfituesit në lidhje me kujdesin për shëndetin dhe masat që duhen marrë për një mirëqenie shëndetësore,
- Këshillon prindërit e fëmijëve (kur është rasti) në nevojë në varësi të problematikës së fëmijëve të tyre (probleme të zhvillimit, ushqyerjes, somatike, çrregullime psiko-emocionale, çrregullime sjelljeje, çrregullime gjumi, çrregullime të sfinkterave),
- Rekomandon rrjetin e shëndetit mendor për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve e individëve me nevoja të veçanta,
- Merr pjesë aktive në mbledhjet e ekipit multidisiplinar,
- Përgatit materiale informative për përfituesit si dhe fletëpalosje mbi tema të ndryshme që prekin shëndetin e tyre,
- Monitoron ecurinë shëndetësore të përfituesve dhe në veçanti fëmijëve frekuentues të shërbimit dhe zhvillimin sipas nevojave individuale,

- Është pjesë e ekipoit të shoqërimit të të miturit në rastet kur është e nevojshme.

Detyrat e edukatorit/animatoret social

- Të përgatisë programin e zhvillimit socio-emocional, bazuar në vlerësimin e statusit të zhvillimit të fëmijës.
 - Të koordinojë zbatimin e programit dhe të kontribuojë përgjatë gjithë progresit të tij dhe vlerësimit të impaktit.

Detyrat e kujdestarit/Ndihmës/kuzhinierit

- Përgatit ushqimet sipas menusë ditore të miratuar më parë nga koordinatori i Qendrës,
 - Kujdeset për fëmijën për higjenën, veshjen, ambientin e fjetjes, qëndrimit,
 - Shpërndan në kohë ushqimin duke respektuar orarin e ushqimit dhe etikën e servirjes,
 - Kujdeset të ruajë kampionet e ushqimeve të përgatitura për 24 orë,
 - Mban pastër dhe në kushte optimale ushqimet dhe pastërti në mjetet e punës dhe mjesidin përreth,
 - Zbaton rigorozisht proçedurat e larjes së enëve,
 - Rinovon çdo muaj librezën shëndetësore.

Detyrat e Sanitarit

- Pastron dhe lanë të gjitha ambientet dhe pajisjet e Qendrës.
 - Grumbullon dhe lagon mbeturinat duke i çuar në vendet e caktuara.
 - Komunikon me fëmijët/përfituesit e Qendrës vetëm për problemet që lidhen me punën e saj/tij.
 - Kujdeset për fëmijën për higjenën, veshjen, ambientin e fietjes, qëndrimit.

Detyra e shoferit

- Mban mjetin në gatishmëri dhe në gjendje pune.
 - Është i gatshëm 24/7 ditë të javës për tiu përgjigjur rasteve në nevojë për mbrojtje.
 - Të jetë i aftë të reagojë në mbështetje të ekipit të emergjencës në rastet e shoqërimit të fëmijëve kur paraqitet nevoja.

BREGULLA TË PËRGJITHSHME

